



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 307 Akti

Nr. 278 Vendimi  
Tiranë, më 22.7.2020

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 16.7.2020, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Selim Kryeziu**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Selim Kryeziu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Apelit Shkodër, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Selim Kryeziu, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 15.3.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Valbona Sanxhaktari, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ) sipas neneve 40 -44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 26.3.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 19.6.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 22.06.2020, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 6.7.2020, ora

---

<sup>1</sup> E-mail, datë 22.6.2020, ora 16:41, “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

9:00; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 22.6.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>2</sup> kërkoi kohë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

8. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>3</sup>, e njoftoi se i jep edhe 6 ditë shtesë dhe shpjegimet dhe provat do të dërgohen brenda datës 12.7.2020.

9. Në datën 24.6.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, kërkoi përsëri kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, pra, më shumë se data e caktuar më 12.7.2020, dhe Komisioni me anë të postës elektronike njoftoi subjektin se ishte njoftuar për kohën shtesë me anë të e-mail-it të datës 24.6.2020.

10. Në datën 10.7.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>4</sup>, paraqiti shpjegimet kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, këto shpjegime së bashku me provat e reja në mbështetje të barrës së provës i dorëzoi fizikisht, ku kishte kërkuar thirrjen si dëshmitar të shtetasve S.K., Gj.Xh., D.D., R.K., I.S., Sh. dhe A.K., N.T., B.Sh., Pronari dhe administratori i një servisi automjesh në Rinas shtetasi M.I. Më tej, përmes postës elektronike<sup>5</sup> subjekti paraqiti prova shtesë.

11. Në datën 14.7.2020, trupi gjykues njoftoi subjektin me anë të postës elektronike, se pasi administroi dhe shqyrtoi kërkesën e subjektit për thirrjen e dëshmitarëve : (1) S.K. dhe Gj. Xh.; (2) D.D. dhe R.K.; (3) I.S.; (4) Sh. dhe A.K.; (4) N.T.; (5) B.Sh.; (6) shtetasit L., me nr. cel.\*\*\*; dhe (7) shtetasi M.I., si dhe pasi mori në shqyrtim këto kërkesa, çmon se thirrja e shtetasve si dëshmitarë është e panevojshme, bazuar në pikën 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, vendosi refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitareve, bazuar në gerrat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

12. Në vendimin nr. 3, datë 14.7.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.7.2020, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

13. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

---

<sup>2</sup> E-mail datë 22.6.2020, ora 19:38, në përgjigje të e-mail-it , “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>3</sup> E-mail, datë 24.6.2020, ora 17:10, “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>4</sup> E-mail datë 10.7.2020, ora 10:30, “Shpjegime dhe parashtrime”.

<sup>5</sup> E-mail datë 11.7.2020, ora 18:08, “Sqarime shtesë”.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

14. Në datën 16.7.2020, ora 11:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

15. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

16. Z. Selim Kryeziu shprehu qëndrimin e tij pasi dëgjoji relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

17. Në seancën dëgjimore të datës 16.7.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për pretendimin e subjektit u shty për në datën 22.7.2020.

18. Në përfundim të seancës së datës 22.7.2020, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Selim Kryeziu dhe shpalli vendimin për procesin e rivlerësimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

20. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.(ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>6</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

<sup>6</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të

dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **V. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 – 2016 dhe në datën 25.10.2016, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në

---

subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

### **Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

26. Për efekt të procesit të rivlerësimit personat që janë hetuar si të lidhur të përfshirë në certifikatën familjare apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë konsideruar: (1) znj. D.K./person i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit; (2) z. I.K./ person i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit; (3) zj. B.K./person i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit; (4) znj. Sh.K. (kunata)/person tjetër i lidhur, si rezultat i dhënies së huas në shumën 10.000 Euro; (5) z. Xh.K. (vëllai/ person tjetër i lidhur, si rezultat i dhënies së huas në shumën 5.000 euro; (6) z. E.H. (S.) (kunati)/person tjetër i lidhur, si rezultat i dhënies së huas në shumën 3.000 euro; (7) z. N.T. (shok)/person tjetër i lidhur, si rezultat i dhënies së huas në shumën 2.000 euro.

### **Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **1. Truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, në Librazhd, me vlerë 150.000 lekë**

**1.1.** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron një truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, në Librazhd, blerë shtetasve S.K. dhe Gj.Xh. me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.6.2000, e regjistruar në ZVRPP-në Librazhd. nr. \*\*\*, datë 12.6.2000. Vlera 150.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi subjekti deklaron të ardhurat familjare. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>7</sup>.

**1.2.** Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit të dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Librazhd<sup>8</sup>, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

**1.3.** Në DPV-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pronësi të tij truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, në vlerë 150.000 lekë, ndodhur tek unaza e qytetit, pas Ndërmarrjes Komonale dhe Elektrikut, ngjitur me lokalit e babait, blerë nga pronarët S.K. dhe Gj.Xh.

**1.4.** Në dokumentacionin e depozituar në deklaratën *Vetting* dhe administruar nga hetimi i Komisionit, rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 8.6.2000, me palë shitëse S.K. dhe Gj.Xh. dhe palë blerëse Selim Kryeziu për blerje trualli me sip. 112

<sup>7</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 8.6.2000, me palë shitëse shtetasit S.K. dhe Gj.Xh. dhe palë blerëse shtetasin Selim Kryeziu, për blerje trualli me sip. 112 m<sup>2</sup>, Librazhd; vlera: 150.000 lekë, vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 8.6.2000; vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 12.6.2000, në pronësi të z. Selim Kryeziu.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 6.11.2019.

m<sup>2</sup>, në Librazhd, me vlerë 150.000 lekë. Për shitjen e truallit shtetasja Gj.Xh., ka emëruar si përfaqësuese ligjore motrën e saj S.K., me anë të prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 7.6.2000.

**1.5.** Nga hetimi i Komisionit rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi. Referuar analizës financiare kronologjike për periudhën 1994 – 2003, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, përfshirë këtu edhe blerjen e truallit me vlerë 150.000 lekë.

## **2. Apartament me sip. 45.51 m<sup>2</sup>, në Librazhd, blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, në vlerën 615.335 lekë**

**2.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron se ka blerë apartament nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan, me kontratën nr. \*\*\*, datë 29.9.2000, në lagjen nr. \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Librazhd, në shumën 615.335 lekë. Pjesa takuese: 50%. Më tej, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: shitur apartamenti i mësipërm në lagjen nr. \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\* me kontratën nr. \*\*\*, datë 2.10.2000, blerësve Q. dhe A.A. në vlerën 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti deklaron të ardhurat familjare dhe kursimet në Francë. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>9</sup>.

**2.2.** Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së<sup>10</sup>, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit ka qenë e regjistruar në regjistrat e ZVRPP- së Librazhd pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 54.44 m<sup>2</sup>, në Librazhd, të cilin e ka shitur në vitin 2000.

**2.3.** Origjina e pronës - kjo pasuri është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\*, datë 29.9.2000, me palë shitëse Entin Kombëtar të Banesave Elbasan dhe palë blerëse Selim Kryeziu, për blerje apartamenti në Librazhd me sip. 45.51 m<sup>2</sup>, me vlerë 615.335 lekë. Sipas kontratës, shuma prej 177.500 lekësh zbritet sipas VKM-së nr. 4, datë 9.1.1995; blerësi ka paguar 53.666 lekë me dokumentin nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, datë 22.12.1998; sipas kontratës, për shlyerjen e plotë të vlerës së apartamentit, blerësit i mbetet të paguajë shumën 384.170 lekë (likuiduar me faturë nr. \*\*\*, datë 29.9.2000). Në kartelën e pasurisë rezulton se ky apartament është blerë nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 437.836 lekë.

**2.4.** Për sa më sipër, nga hetimi rezulton se ky apartament është blerë në vlerën 437.836 lekë dhe jo në vlerën 615.335 lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

**2.5.** Më tej, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 2.10.2000, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë apartament palës blerëse Q. dhe A.A., në vlerën 1.400.000 lekë.

**2.6.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë apartament 3 ditë pasi e ka përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan. Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit i është

---

<sup>9</sup>Kontratë shitjeje apartament banimi me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\*, datë 29.9.2000, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave Elbasan dhe palë blerëse shtetasi Selim Kryeziu; kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 2.10.2000, me palë shitëse shtetasin Selim Kryeziu dhe palë blerëse shtetasit Q. dhe A.A.

<sup>10</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2017, e ZVRPP-së Librazhd.

kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor justifikues pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga ky transaksion. Në përgjigje<sup>11</sup> subjekti deklaroi se janë paguar detyrimet tatimore dhe ka vënë në dispozicion shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, lëshuar nga ASHK-ja. Më tej, subjekti shpjegon se blerësit Q. dhe A.A., ishin zotërues të paligjshëm të apartamentit, zënë me forcë në vitin 1997, për këtë shkak duke pasur një ndjenjë humanizmi ndaj tyre (periudhë në të cilën subjekti ka qenë në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Librazhd), me ndërmjetësimin e disa të afërmeve të tyre, sapo e ka blerë këtë apartament nga EKB-ja, ua ka shitur atë blerësve shumë poshtë vlerës që realisht kishte ky apartament, i cili ishte në katin përdhe të pallatit, i kërkuar edhe për biznese të ndryshme.

**2.7.** Pas verifikimit të mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 5.10.2000, konfirmohet se subjekti ka paguar vlerën 7.000 lekë, si tatim mbi të ardhurat (140.000 lekë \* 0.5%=7.000), sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.10.2000.

**2.8.** Më tej, pasi administroi praktikën e plotë të privatizimit të apartamentit nga EKB-ja<sup>12</sup>, Komisioni vëren se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.8.1998, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Bashkisë Librazhd për të filluar procedurat e përsheptuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, z. Selim Kryeziu, duke parë gjendjen e vështirë të tij, pasi banonte në pallatin nr. \*\*\*, lagja nr. \*\*\*, Librazhd, së bashku me prindërit dhe dy vëllezërit e martuar, në një hyrje 2+1. Më tej, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.12.1998, “Për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd”, Bashkia Librazhd, ka vendosur t’i japë për strehim subjektit apartamenti nr. \*\*\*, p. \*\*\*, sh. \*\*\*. Gjithashtu, në praktikën e përcjellë gjendet e administruar shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2000, nga EKB-ja Librazhd, drejtuar Komisariatit të Policisë Librazhd, ku kërkohet lirimi i apartamentit nga shtetasi Q.A., i cili e ka zënë arbitrarisht nga vitit 1997.

**2.9.** Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga EKB-ja Librazhd, konstatohet se ky apartament ka qenë objekt i një konflikti gjyqësor, ku me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2000, të Gjykatës së Apelit Durrës, u vendos ndryshimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 7.7.1999, i Gjykatës së Rrethit Elbasan, në të cilin ishte vendosur pranimi i kërkesë padisë duke shfuqizuar vendimin nr. \*\*\*, datë 18.12.1998, për dhënien e këtij apartamenti subjektit të rivlerësimit.

**2.10.** Lidhur me burimin e krijimit - Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 1994 – 2003, dhe rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, përfshirë këtu edhe blerjen e apartamentit nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan, me vlerën 437.835 lekë.

Më tej, nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Librazhd<sup>13</sup>, rezultoi se në emër të personit tjetër të lidhur, z. R.K./babai i subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Librazhd, e llojit apartamentit me sip. 62.15 m<sup>2</sup>, regjistruar në pronësi si familje. Sipas formularit nr. 3, është lidhur “kontratë për privatizimin e banesës”, datë 17.4.1993, ndërmjet Ndërmarrjes Komunale

<sup>11</sup>Protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 25.2.2020.

<sup>12</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2019.

<sup>13</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019.



Banesave dhe z. R.K., dhe me kontratën e shijes nr. \*\*\*, datë 10.5.1993, është shitur në vlerën 3.995 lekë. Ky apartament figuron i regjistruar në emër të R., F., S., R., Xh. dhe Dh.K. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003 dhe në deklaratat periodike, ndër vite, bashkëpronësinë mbi apartamentin e përfituar nëpërmjet privatizimit në vitin 1993.

**2.11.** Për sa më sipër u analizua, bazuar në nenin 23, të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, përcaktohet se: *“Me zbatimin e këtij ligji, në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore”*. Në këto kushte subjekti nuk mund të ishte përfitues i apartamentit me sip. 45.51 m<sup>2</sup> nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan në vitin 2000, duke qenë se figuron bashkëpronar i një apartamenti të përfituar nga privatizimi në vitin 1993.

**2.12.** Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me: (i) ka pasaktësi në deklarimin e vlerës së apartamentit të përfituar nga EKB-ja Librazhd, pasi nga hetimi rezulton se ky apartament është blerë në vlerën 437.836 lekë dhe jo në vlerën 615.335 lekë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003 dhe në deklaratat periodike, ndër vite, bashkëpronësinë mbi apartamentin me sip. 62.15 m<sup>2</sup> të përfituar nga privatizimit në vitin 1993; (iii) subjekti i rivlerësimit ka përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, apartamentin e dytë me sip. 45.51 m<sup>2</sup>, si dhe nuk e ka përdorur për qëllimin për të cilin ishte dhënë, por e ka shitur këtë apartament 3 ditë pasi e ka blerë nga EKB-ja dhe ka përfituar shumën prej 962. 565 lekësh.

**2.13.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: [...] Pasaktësitë në deklarimin e vlerës së apartamentit të përfituar nga EKB-ja Librazhd kanë ndodhur për faktin se ka kaluar një periudhë 20 vjeçare. Ndërkohë mosdeklarimi i bashkëpronësinë mbi apartamentin me sip. 62.15 m<sup>2</sup>, ka ardhur si pasojë e harresës. Këtë apartament, prindërit e subjektit e kanë përfituar në mënyrë të ligjshme dhe me vendim të organeve kompetente shtetërore. Gjithashtu, edhe subjekti ka përfituar një apartament nga EKB-ja, sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi, po ashtu edhe vëllai i tij Q.K. Lidhur me përfitimin e apartamentit në vitin 2000, subjekti deklaroi se privatizimi i këtij apartamenti është bërë në respektim të plotë me procedurat ligjore, me një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë drejtuar Bashkisë Librazhd për shkak të kushteve tepër të vështira ku banonte së bashku me disa pjesëtarë të familjes në një apartament me sip. 62.15 m<sup>2</sup>. Më tej, duke qenë se apartamenti i privatizuar nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë i zënë me forcë, pas kërkesës së shtetasve Q. dhe A.A., ua ka shitur këtyre të fundit dhe me paratë e përfituara ka blerë një apartament tjetër, për të cilin kishte nevojë urgjente, duke deklaruar se nuk ka blerë biznes, apo këto para nuk i ka përdorur për ndonjë qëllim tjetër, përveçse për strehim dhe banim.

**2.14.** Më tej, subjekti ngre pretendime lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve jetike nga Komisioni duke u bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe jo INSTAT-it, mospërfshirjen në analizën financiare për periudhën 1994 – 2003 të të ardhurave nga shitja e apartamentit në shumën 1.400.000 lekë dhe shpenzimeve për blerjen e apartamentit në shumën 1.200.000 lekë, si dhe për reduktimin e shpenzimeve jetike gjatë periudhës që ka jetuar me prindërit.

## **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**2.15.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**2.16.** Lidhur me pretendimet e subjektit për përlogaritjen e shpenzimeve jetike nga Komisioni duke u bazuar në ILDKPKI dhe jo INSTAT, dhe reduktimit të shpenzimeve jetike gjatë periudhës që ka jetuar me prindërit, Komisioni analizon se subjekti i është vënë në dispozicion shkresa nr. \*\*\*, dt. 4.3.2019 e ILDKPKI, ku specifikohet niveli i shpenzimeve jetike për çdo vit kalendarik dhe bashkëlidhur së cilës ndodhet e gjithë korrespondenca zyrtare ndërmjet INSTAT dhe ILDKPKI. Së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, subjekti i është vendosur në dispozicion Aneksi 02, ku është cituar pikërisht kjo shkresë, e më tej është sqaruar vlera e përdorur për shpenzimet jetike të vitit 2007. Nga ana tjetër, Komisioni evidenton se subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues për të mbështetur nivelin e shpenzimeve jetike përdorur në analizën financiare të dorëzuar nga ana e tij. Më tej, lidhur me pretendimin e subjektit në prapësime për mospërfshirjen në analizën financiare kronologjike 1994 – 2003 të të ardhurave nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.10.2000, në shumën 1.400.000 lekë dhe shpenzimeve për blerjen e apartamentit me sip. 40.4 m<sup>2</sup>, në Librazhd, në shumën 1.200.000 lekë, Komisioni vëren se të dyja këto shifra janë të përfshira në tabelën e analizës financiare kronologjike 1994 – 2003 në pikën 1.7 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht<sup>14</sup>.

**2.17.** Lidhur me pasaktësitë në deklarimin e vlerës së apartamentit të përfituar nga EKB-ja Librazhd, Komisioni bazuar në shpjegimet dhe provat e administruara gjatë hetimit çmon se subjekti shpjegoi bindshëm mospërputhjet e konstatuara.

**2.18.** Referuar konstatimeve të tjera, si më lart, Komisioni çmon se subjekti të rivlerësimit nga institucionet shtetërore i është mundësuar të përfitojë dy herë nga ligji i privatizimit të banesave. Ministria e Drejtësisë, si rezultat i gjendjes së vështirë të banimit, ka kërkuar fillimin e procedurave të përshpejtuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, z. Selim Kryeziu, por apartamentin e përfituar me privatizim subjekti nuk e ka përdorur për qëllimin për të cilin i ishte dhënë. Pretendimet e tij se i ndikuar nga ndjenja e humanizmit është nxitur ta shesë këtë apartament nuk duken bindëse, konstatohet se apartamenti është shitur 3 herë më shtrenjtë dhe ka fituar një shumë prej 962.565 lekësh. Gjithashtu, apartamenti i ri është blerë në datë 26.12.2000, pra, tre muaj më pas, fakt tjetër ky që bie në kundërshtim me pretendimet e subjektit se gjendej në kushte tepër të vështira banimi dhe ishte në nevoja urgjente strehimi.

**2.19.** Komisioni, në rastin konkret kur subjekti i rivlerësimit e ka përdorur apartamentin e përfituar nga EKB-ja, për qëllim fitimi, çmon se sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit dhe ndikimi i tij në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ka një rëndësi të veçantë dhe është objekt

---

<sup>14</sup> Konkretisht, në rreshtin 19 dhe 21 të tabelës.

rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri. Kodi i Etikës Gjyqësore, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, datë 8.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “...gjyqtari nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave privatë dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t`u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë”.

**2.20.** Ndërkohë lidhur me mosdeklarimin e bashkëpronësinë mbi apartamentin me sip. 62.15 m<sup>2</sup>, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, në këto kushte bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84.2016, Komisioni vëren se subjekti nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me bashkëpronësinë në këtë apartament të përfituar nëpërmjet privatizimit në vitin 1993.

### **3. Apartament me sip. 40.4 m<sup>2</sup>, në Librazhd, në vlerën 1.200.000 lekë**

**3.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë apartament në Librazhd me sip. 40.4 m<sup>2</sup> nga shitësit K. dhe H.Zh. me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.12.2000. Vlera: 1.200.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Më tej, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: shitur apartamenti me sip. 40.4 m<sup>2</sup> blerësit O. dhe A.M. me kontratën nr. \*\*\*, datë 10.10.2005, në vlerën 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti deklaroi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit më sipër me sip. 45.51 m<sup>2</sup>, Librazhd. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>15</sup>.

**3.2.** Nga hetimi i Komisionit bazuar në dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Librazhd<sup>16</sup>, konstatohet se në emër të subjektit të rivlerësimit ka qenë e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Librazhd e llojit apartament me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, e shitur në datën 10.10.2005. Kjo pasuri është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.12.2000, me palë shitëse K. e H.Zh. dhe palë blerëse Selim Kryeziu, në Librazhd, në vlerën 1.200.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më vonë, subjekti me kontratën nr. \*\*\*, datë 10.10.2005, ia ka shitur këtë apartament palës blerëse O. dhe A.M., në vlerë 1.900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**3.3.** Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar se zotëron apartament banimi ndërtuar para vitit 1999, me sip. 40,4 m<sup>2</sup> (1 dhomë e kuzhinë), ndodhur në L. \*\*\*, p. \*\*\*, Librazhd, në vlerën 1.200.000 lekë, blerë nga pronarët K. e H.Zh., pas shitjes së apartamentit të marrë nga EKB-ja Elbasan. Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: shitur z. O.M. apartament banimi 1+1, në L. \*\*\*, p. \*\*\*, Librazhd, në vlerën 2.500.000 lekë. Sipas DPV-së së vitit 2005, subjekti e ka deklaruar vlerën e shitjes së këtij apartamenti në shumën 2.500.000 lekë, ndërkohë referuar kontratës së shitjes vlera është 1.900.000 lekë. Pra, ka mospërputhje midis deklaramit dhe dokumentacionit të administruar.

**3.4.** Në lidhje me këto mospërputhje, me anë të pyetësorit nr. 2 subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor justifikues pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga ky transaksion. Në përgjigje të pyetësorit<sup>17</sup>, subjekti

<sup>15</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.12.2000, me palë shitëse shtetasit K. dhe H.Zh. dhe palë blerëse shtetasin Selim Kryeziu, kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 10.10.2005, me palë shitëse shtetasin Selim Kryeziu dhe palë blerëse shtetasit O. dhe A.M.

<sup>16</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019.

<sup>17</sup>Protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 25.2.2020.

deklaroi se këtë apartament e ka shitur në shumën 1.900.000 lekë dhe gabimisht në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar vlerën 2.500.000 lekë, pasi vlerës 1.900.000 lekë, i ka shtuar vlerën prej 600.000 lekësh, kursyer nga studimet e tij në Francë. Më tej, sqaroi se janë paguar detyrimet tatimore vërtetuar kjo me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, lëshuar nga ASHK-ja.

**3.5.** Pas verifikimit të mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 10.10.2005, Komisioni konstaton se subjekti ka paguar tatim mbi të ardhurat sipas kontratës nr. \*\*\*, në vlerën  $1.900.000 \cdot 0.5\% = 9.500$  lekë.

**3.6.** Më tej, pas kalimit të barrës së provës, Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit pasi konstatohet se nuk ka deklaruar ku ka jetuar nga momenti i shitjes së apartamentit (datë 10.10.2005), deri në tetor të vitit 2006, kohë kur ka deklaruar se ka filluar të banojë në apartamentin e blerë në Tiranë, të ndodhur në Rr. “\*\*\*”.

**3.7.** Subjekti i rivlerësimit shpjegoi duke deklaruar se: [...] Gjatë periudhës që ka shitur apartamentin në Librazhd, deri në mesin e muajit tetor 2006, ka jetuar në një apartament me prindërit, apartamentin e shitur nuk e ka liruuar menjëherë në datën 10.10.2005, por më pas, duke qenë se i është dashur të heqë shumë pajisje, të cilat nuk ishin përfshirë në çmimin e shitjes. Këto pajisje i ka futur tek lokali i babait, në një dhomë e cila përdorej edhe për fjetje. Ndërkohë, si magazinë të lokalit kanë përdorur një vend strehim me mbi 5 dhoma që përdorej prej tyre që ndodhej poshtë lokalit të babait. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi deklaratën e lëshuar në datën 4.7.2020 nga z. R.K.

**3.8.** Komisioni vëren se bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84.2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaratim të saktë lidhur me periudhën në të cilën ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij.

**3.9.** Më tej, Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi të ardhura të kursyera nga studimet në Francë, për periudhën 1.5.1996 – 31.12.1997, me bursë të shtetit francez, 5.565 franga franceze në muaj sipas vërtetimit të bursës. Shuma e kursyer: 600.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë, me burim nga kursimet familjare me bashkëshorten dhe kursimet e bursës së studimit në Francë. Të ardhurat nga kursimet e studimeve në Francë, subjekti i ka deklaruar edhe si burim për blerjen e apartamentit të përfutur nga EKB-ja. Shuma e kursyer prej 600.000 lekë nuk është saktësuar në DPV-në e vitit 2003, por vetëm në deklaratën *Vetting*.

**3.10.** Për sa më lart, Komisioni, për efekt të analizës financiare do të konsiderojë si të ardhura të përfutura nga shitja e apartamentit shumën prej 1.900.000 lekë, e cila rezulton në kontratën e shitjes dhe mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 10.10.2005. Në lidhje me të ardhurat prej 600.000 lekësh të deklaruara si të kursyera nga bursa, Komisioni nuk i mori në konsideratë pasi bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin.

**3.11.** Në lidhje me mundësitë financiare për blerjen e apartamentit, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 1994 – 2003, duke i konsideruar të ligjshme të ardhurat e

përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 45.51 m<sup>2</sup>, në shumën 1.400.000 lekë, derisa subjekti të japë shpjegime dhe prova në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të këtij apartamenti.

**3.12.** Nga faktet e analizuar, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi përsëri subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mospërputhjet midis deklarimit të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionit të administruar nga njëra anë në DPV-në e vitit 2005.

**3.13.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se: [...] Në deklaratën e vitit 2005 gabimisht ka deklaruar se apartamentin e ka shitur në vlerën 2.500.000 lekë, ndërkohë që sipas kontratës së shitjes vlera është 1.900.000 lekë, pra, gabimisht vlerës së shitjes i ka shtuar edhe kursimet gjatë studimeve në Francë në shumën 600.000 lekë. Më tej, subjekti kërkoi që shuma prej 600.000 lekë përfituar nga bursa e studimeve në Francë, të llogaritet si e ardhur e kursyer për periudhën maj 1996 – dhjetor 1997. Subjekti dorëzoi si provë përgjigjen e marrë nga Ambasada e Republikës Franceze në Tiranë, datë 26.6.2020, e cila ka konfirmuar se duket plotësisht e besueshme që subjekti i rivlerësimit të ketë kursyer ekuivalentin e 600.000 lekëve gjatë qëndrimit të tij në Francë, përgjatë 20 muajve.

#### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.14.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**3.15.** Lidhur me pretendimin e subjektit për llogaritjen e shumës 600.000 lekë si kursime të përfituara nga bursa e studimeve në Francë, Komisioni vlerëson se edhe në qoftë se do të merret në konsideratë ky pretendim, efekti në analizën financiare do të jetë rritja e balancës pozitive në fund të vitit 2003, dhe jo rritja e shumës së kursimeve *cash* në këtë datë, e deklaruar në shumën 1.000.000 lekë. Duke qenë se balanca në fund të vitit 2003 rezultoi pozitive në shumën 208.046 lekë, në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht subjektit nuk iu kalua barra e provës. Gjithashtu, Komisioni çmon se kjo shumë nuk mund të paraqitet në analizën financiare në vitin 2006, siç është vepruar në aktin e ekspertimit të paraqitur nga subjekti në prapësime, pasi është përfshirë në kursimet *cash* në vlerën 1.000.000 lekë.

**3.16.** Në konkluzion, referuar mospërputhjeve lidhur me vlerën e apartamentit, Komisioni për efekt të analizës financiare vendosi të marrë në konsideratë vlerën 1.900.000 lekë, bazuar kjo dhe në çmimin e kontratës së shitblerjes.

#### **4. Apartament me sip. 98 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vlerë 60.000 euro**

**4.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë apartament në Tiranë me sip. 98 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në vlerën 60.000 Euro. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi për blerjen e

apartamentit, subjekti deklaron: nga shitja e apartamentit në Librazhd; kursime familjare; si dhe hua pa interes dhe afat, në lerën 10.000 euro kumatës Sh.K. me biznes privat (shlyer në vitet 2009-2010); në vlerën 5.000 euro vëllait Xh.K. nga puna si kuzhinier në Greqi (shlyer në vitet 2007-2008); në vlerën 3.000 euro kumatit E.H. (S.) nga puna si emigrant në Greqi (shlyer në vitin 2008); si dhe në vlerën 2.000 euro shokut, N.T. me biznese private në Librazhd (shlyer në vitet 2007-2008). Për vërtetimin e deklarimeve të tij subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>18</sup>.

**4.2.** Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>19</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit figuron pasuri e transkriptuar e llojit apartament me sip. 98 m<sup>2</sup>, pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë.

**4.3.** Kjo pasuri është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, me palë shitëse shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., dhe palë blerëse Selim Kryeziu, në vlerën 60.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**4.4.** Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: prenotim apartamenti në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, shlyer 50 % e vlerës ose 32.000 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*” sipas kontratës noteriale, datë 12.10.2005. Detyrim i mbetur ndaj shoqërisë është 29.480 euro. Rezulton se vlera totale e këtij apartamenti është 61.480 euro (32.000 + 29.480 euro).

**4.5.** Në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës 2006 (në pozicionin e inspektorit pranë KLD-së), subjekti ka deklaruar se ka i paguar 55.000 euro shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Për sa u analizua, konstatohet se subjekti në vitin 2006, ka shlyer vlerën 23.000 euro. Sipas detyrimit të mbetur të deklaruar në vitin 2005, rezulton që në vitin 2006 subjekti të ketë detyrim të mbetur ndaj firmës në vlerën 6.480 euro, detyrim i cili nuk është deklaruar në deklaratimet e interesave private periodike vjetore nga viti 2006 dhe në vijim. Bazuar germën “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, personi i lidhur mbart detyrimin të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.

**4.6.** Me anë të pyetësorit nr. 2 subjektit i është kërkuar të paraqesë kontratën e sipërmarrjes datë 12.10.2005, për prenotim apartamenti, të japë shpjegime të hollësishme lidhur me kohën/këstet e likuidimit të pagesave dhe burimet, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues lidhur me pagesat, huatë private dhe likuidimin e tyre. Në përgjigje të pyetësorit<sup>20</sup>, subjekti depozitoi kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.10.2005, ndërmjet palëve kontraktuese shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësi Selim Kryeziu. Subjekti deklaroi se është i vetmi blerës në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. që e ka blerë apartamentin më

---

<sup>18</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, me palë shitëse shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasi Selim Kryeziu; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 22.5.2015, apartament me sip. 98 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit Selim Kryeziu.

<sup>19</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019.

<sup>20</sup> Protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 25.2.2020.

shtrenjtë nga të gjithë banorët e tjerë<sup>21</sup> dhe se mandatpagesat nuk i disponon dhe se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk mban mend nëse i ka disponuar ndonjëherë, duke qenë se ka pasur njohje me administratorët e kësaj shoqërie dhe prej tyre nuk janë vënë ndonjëherë në dyshim pagesat e kryera.

**4.7.** Lidhur me detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., subjekti deklaron se në DPV-në e vitit 2006 detyrimi i mbetur është në vlerën 5.000 euro dhe jo 6.480 euro. Diferenca në vlerën prej 1.480 euro, vjen si rezultat i rumbullakosjes së çmimit përfundimtar në vlerën 60.000 Euro. Kjo për shkak se shoqëria nuk kreu disa nga punimet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes, deklaruar edhe në pyetësin nr. 1.

**4.8.** Subjekti sqaron se e ka rregulluar vetë tualetin e vogël në hyrje të apartamentit, të cilin nuk ia kishte kërkuar shoqërisë ta ndërtonte, pasi nuk kishte mundësi dhe kjo vlerë u zbrit nga çmimi i blerjes në kontratën e porosisë. Subjekti deklaron se punimet i ka kryer vëllai i tij dhe shoku i fëmijërisë D.D., nuk ka paguar për hakun e punës dhe as për pllakat, të cilat kanë tepruar nga ndërtimi i shtëpisë së vëllait. Ndërkohë, dera dhe pajisjet kanë kushtuar rreth 20.000 lekë.

**4.9.** Lidhur me mosdeklarimin e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë, subjekti shprehet se duke qenë se ka deklaruar në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës 2006, se ka paguar shumën 55.000 euro, është e kuptueshme se ndaj kësaj shoqërie ekzistonte detyrimi prej 5.000 euro, që është shuar në datën 31.12.2017, referuar kontratës nr. \*\*\*, datë 31.12.2007.

**4.10.** Më tej, subjekti deklaron se për pagesat e detyrimeve në shumën 20.000 euro (hua pa interes dhe afat dhe pa kontratë), të cilat i ka kthyer, nuk disponon dokumente justifikuese, pasi kanë qenë detyrime pa kontratë, janë shlyer nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe nga pagesat si ekspert në Brindisi, Itali.

**4.11.** Komisioni konstaton se referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.10.2005, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., merr përsipër të ndërtojë një apartament me sip. 106 m<sup>2</sup>, me çmimin 580 euro/m<sup>2</sup>. Pagesa do të kryhet në këto afate: (i) kësti i parë prej 32.000 euro, është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate; (ii) kësti i dytë prej 10.000 euro, do të paguhet në datën 30.3.2006; (iii) kësti i tretë prej 9.480 euro, do të paguhet në momentin e shtrimit të pllakave; (iv) kësti i katërt prej 10.000 euro, do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit. Sipas kontratës shuma totale për t’u paguar është në vlerën 61.480 euro.

**4.12.** Shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (aktualisht kjo shoqëri figuron me emrin “\*\*\*”), iu kërkuar informacion dhe në përgjigjet<sup>22</sup> e saj ka vënë në dispozicion të Komisionit vetëm kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, duke shpjeguar se nuk disponon dokumentacion tjetër shoqëruar për shkak se ka kaluar afati i ruajtjes.

---

<sup>21</sup> Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4<sup>21</sup>, ka paraqitur deklaratën (jo noteriale), datë 15.5.2020 të z. B.Sh. (administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.), i cili deklaron se ky apartament i është shitur subjektit më shtrenjtë se blerësve të tjerë.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot, datë 18.5.2020.

**4.13.** Rezulton se ky apartament është shitur me kontratën e shitjes me rezervë dhe kusht kreditimi nr. \*\*\*, datë 22.8.2017, me palë shitëse Selim Kryeziu dhe palë blerëse R. e E.D., në vlerën 75.000 euro, nga të cilat: 15.000 euro në llogarinë e noterit; 5.700.000 lekë/42.000 euro do të likuidohen me marrjen e kredisë nga “Raiffeisen Bank”, brenda datës 20.10.2017; kësti i tretë 18.000 euro do të likuidohet para datës së disbursimit të kredisë ose kur kredia do të kalojë në llogarinë bankare të noterit. Në dosjen e ILDKPKI-së, gjendet e administruar deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 20.10.2017<sup>23</sup>, ku deklarohet likuidimi total i shumës në favor të shitësve Selim dhe D.K. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>24</sup>, konstatohet se në datën 17.10.2017, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është transferuar vlera prej 75.000 euro nga Dh.Q. Person Fizik, me përshkrim: *“pagesë sipas kontratës shitje pasurie paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.8.17”*.

**4.14.** Referuar shkresës së ASHK-së<sup>25</sup>, rezulton se llogaritja e tatim fitimit për këtë apartament është bërë mbi diferencën e çmimit të kontratës së shitjes 9.921.000 lekë me çmimin e mëparshëm prej 7.306.800 lekë, në vlerë 2.614.200 lekë. Shuma e tatimit për t’u paguar ka qenë 392.130 lekë, pagesë e cila është deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vjetore periodike të vitit 2017.

#### **Lidhur me burimin e krijimit**

**4.15.** Në mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për datat e pagesës së kësteve, Komisioni vlerësoi që analiza financiare duhet kryer në datat në vijim: (i) për këstin e parë në vlerën 32.000 euro është konsideruar, moment pagese, data 12.10.2005, bazuar në kontratën e sipërmarrjes paragrafi “pagesa e kësteve” dhe deklarimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2005; (ii) për këstin e dytë në vlerën 23.000 euro është konsideruar, moment pagese, data 15.11.2006, bazuar në deklarimin e subjektit në deklaratën përpara fillimit të detyrës si anëtar i KLD-së, dorëzuar në datën 16.11.2006, ku deklaroi se ka paguar 55.000 euro për prenotimin e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k; (iii) për këstin e tretë në vlerën 5.000 euro është konsideruar, moment pagese, data 31.12.2007, bazuar në deklarimin e subjektit në pyetësozin nr. 2, ku deklaroi se detyrimi i mbetur prej 5.000 euro është shuar në datën 31.12.2007 dhe referuar kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, ku citohet se çmimi i shitblerjes prej 60.000 euro është shlyer jashtë zyrës noteriale.

#### **Analizimi i mundësisë financiare për pagimin e këstit të parë në vlerën 32.000 euro**

**4.16.** Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në datën 12.10.2005.

**4.17.** Lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruar në vitin 2003, Komisioni konstaton se në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka deklaruar vlerën 1.000.000 lekë gjendje *cash* në banesë në datën 31.12.2003, si kursime familjare me bashkëshorten dhe nga bursa e studimit në Francë. Më tej, në deklaratat periodike të viteve 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar pakësime/shtesa të kësaj vlere dhe as gjendje *cash*.

---

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 16.4.2018.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 27.10.2019.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2018, e administruar në dosjen e ILDKPKI-së.



**4.18.** Në pyetësin nr. 3, subjekti iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë fakt dhe në përgjigje shpjegoi se për shkak të moskuptimit të saktë të mënyrës së plotësimit të deklaratave të pasurisë, rubrika pakësime/shtesa për disa vite nuk është plotësuar saktë prej tij. Më tej, subjekti deklaroi se nga përfundimi i studimeve në dhjetor 1997 deri në vitin 2010, të gjitha paratë i ka pasur *cash*, për shkak se ka bërë likuidimin e huave të marra të të tretët, hua të cilat janë shlyer ndër vite siç janë deklaruar në deklaratat përkatëse.

**4.19.** Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar si burim kursimet e tij në momentin e deklarimit të shlyerjes së këtyre huave. Për më tepër, bazuar në këtë shpjegim, subjekti ka marrë hua nga të tretë ndërkohë që kishte gjendje likuiditete *cash* dhe me këto para ka shlyer më vonë detyrimin ndaj tyre, çka duket jashtë logjikës ekonomike.

**4.20.** Për këtë arsye, duke analizuar mënyrën e deklarimit në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në deklaratat e viteve 2011 dhe në vijim, si edhe duke konstatuar që subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006 (si anëtar i KLD-së), Komisioni konsideroi që likuiditetet *cash* në fund të vitit 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 kanë qenë 0 (zero) lekë.

**4.21.** Nga analiza financiare në datën 12.10.2005, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në shumën 1.898.258 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

#### **Analizimi i mundësisë financiare për pagimin e këstit të dytë në vlerën 23.000 euro**

**4.22.** Në lidhje me shumën 3.000 euro nga kursimet, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në datë 15.11.2006, e cila rezultoi me një balancë pozitive prej 357.367 lekë. Në lidhje me shumën e marra hua nga personat e tjerë të lidhur (20.000 euro në total) Komisioni analizoi, si vijon:

**4.23.** Për sa i përket huas në vlerën 10.000 euro nga kunata Sh.K., në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se shtetasja Sh.K. ka punuar për shumë vite me biznes privat në Përrenjas, disponon pasuri të regjistruara: 2 apartamente; 2 dyqane; dhe 1 makinë, dhe se shuma është shlyer në vitet 2009 – 2010 (respektivisht 5.000 euro çdo vit). Subjekti ka paraqitur: (i) vërtetimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2019, të Drejtorisë Rajonale Elbasan, lidhur me të dhënat e Personit Fizik “\*\*\*”; (ii) certifikatë pronësie, datë 12.10.2004, për pasurinë e llojit njësi me sip. 20.64 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të A.K.; (iii) certifikatë pronësie, datë 12.10.2004, për pasurinë e llojit njësi me sip. 18.5 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të A.K.; (iv) certifikatë pronësie datë 12.1.2010, për pasurinë e llojit apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të A.K.; (v) certifikatë pronësie datë 18.6.2010, për pasurinë e llojit apartament me sip. 36.1 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasve A. dhe Sh.K.

**4.24.** Lidhur me deklarimin ndër vite, konstatohet se subjekti e ka deklaruar detyrimin e shumës prej 10.000 euro në DPV-në e vitit 2006, e më tej edhe shlyerjen e tij në deklaratat periodike përkatëse, konkretisht, vlerën 5.000 euro në deklaratën e vitit 2009 dhe vlerën 5.000 euro në deklaratën e vitit 2010. Më tej, Komisioni vëren se dokumentacioni i dorëzuar nga

subjekti nuk provon mundësitë financiare të ligjshme të shtetases Sh.K. për të dhënë hua shumën 10.000 euro, në vitin 2006.

**4.25.** Në informacionin e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan<sup>26</sup> konstatohet se shtetasja Sh.K. është e regjistruar si Person Fizik në datën 13.3.2001 me NIPT \*\*\* me aktivitet “tregti me pakicë e veshjeve” dhe është çregjistruar në datën 1.4.2011. Gjatë kësaj periudhe subjekti nuk ka asnjë deklaratë të bërë prej tij, nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe nuk ka deklaruar asnjë listëpagesë për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit, nuk rezulton që ky shtetas të ketë gjeneruar të ardhura përpara vitit 2006.

**4.26.** Për sa i përket huas në vlerën 5.000 euro, marrë nga vëllai Xh.K., në pyetësin standard subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna si kuzhinier në Librazhd (ka punuar që para viteve 1990 si kuzhinier në hotel “\*\*\*\*”, si dhe në lokalin e babait) dhe në Greqi/Halkidiki (\*\*\*), si dhe nga shitja e apartamentit në Librazhd. Më tej, subjekti deklaron se, aktualisht, vëllai punon si kuzhinier në Tiranë dhe se shuma është shlyer në vitet 2007 – 2008 (respektivisht vlera 3.000 euro në vitin 2007 dhe vlerat 2.000 euro në vitin 2008). Subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje apartamenti nr. \*\*\*, datë 23.7.2008, me palë shitëse z. Xh.K. dhe palë blerëse z. N.C., për apartamentin me sip. 40.40 m<sup>2</sup>, me çmim 1.500.000 lekë, ndodhur në Librazhd (bashkëlidhur certifikata e pronësisë).

**4.27.** Lidhur me deklarin ndë vite, Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar detyrimin e vlerës prej 5.000 euro në DPV-në e vitit 2006, e më tej edhe shlyerjen e saj në deklaratat periodike përkatëse, konkretisht, vlerën 3.000 euro në deklaratën e vitit 2007 dhe vlerën 2.000 euro në deklaratën e vitit 2008. Vërehet se kontrata e shitjes së apartamentit mban datën 23.7.2008 dhe në kontratë citohet se shumën prej 1.500.000 lekësh shitësi e ka marrë ditën e nënshkrimit të kontratës jashtë kësaj zyre. Pra, të ardhurat nga shitja e apartamentit janë përfituar pas dhënies së huas në vitin 2006, ndërkohë që për të ardhurat nga puna si kuzhinier, subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion provues.

**4.28.** Për sa i përket huas në vlerën 3.000 euro nga kunati, vëllai i bashkëshortes së subjektit, z. E.S. (H.), subjekti në pyetësin standard ka deklaruar si burim krijimi punën si emigrant në Greqi (banon në Athinë që nga viti 1990), shitjen e apartamentit në Përrenjas dhe se shuma është shlyer në vitin 2008. Subjekti ka paraqitur: (i) fotokopje dokumentacioni që vërteton rezidencën e këtij shtetasi në Greqi<sup>27</sup>; dhe (ii) kontratë shitblerjeje apartamenti nr. \*\*\*, datë 15.4.2010, me palë shitëse z. E.S. dhe palë blerëse z. A.M., për apartamentin me sip. 59.6 m<sup>2</sup>, me çmim 2.303.540 lekë, ndodhur në Përrenjas/Librazhd (bashkëlidhur certifikata e pronësisë).

**4.29.** Lidhur me deklarin ndë vite, Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar detyrimin e vlerës prej 3.000 euro në DPV-në e vitit 2006, e më tej edhe shlyerjen e saj në deklaratën periodike të vitit 2008. Vërehet se kontrata e shitjes së apartamentit mban datën 15.4.2010 dhe në kontratë citohet se të hollat janë likuiduar, sot, në dorë jashtë zyrës noteriale.

---

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 7.11.2019.

<sup>27</sup> Fotokopje kartë rezidence në shtetin grek; fotokopje fature energjie elektrike datë 25.1.2019 dhe fotokopje dokumentesh të tjera në gjuhën greke të papërkthyer.

Kjo konfirmohet edhe nga lëvizja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”<sup>28</sup>, ku konstatohet se në datën 16.4.2010, ky shtetas ka depozituar vlerën 2.000.000 lekë në llogarinë e tij me përshkrim “derdh depozitë 12-mujore nga shitje shtëpie”. Pra, të ardhurat nga shitja e apartamentit janë përfitur pas dhënies së huas në vitin 2006. Ndërkohë që për të ardhurat nga puna në Greqi, subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion provues.

**4.30.** Për sa i përket huas në vlerën 2.000 euro, nga person tjetër i lidhur/N.T., në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se ky shtetas ka disa biznese private në Librazhd dhe se shuma është shlyer në vitet 2007 – 2008 (respektivisht, në vlerën 1.000 euro/vit). Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues.

**4.31.** Lidhur me deklarinin ndër vite, Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar detyrimin e shumës prej 2.000 euro në DPV-në e vitit 2006, e më tej edhe shlyerjen e saj në deklaratat periodike përkatëse, konkretisht, vlerën 1.000 euro në deklaratën e vitit 2007 dhe vlerën 1.000 euro në deklaratën e vitit 2008. Nga hetimi i Komisionit, konkretisht, bazuar në përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan<sup>29</sup>, rezulton se shtetasi N.T. është administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\*. Më tej, DRT-ja Elbasan ka vënë në dispozicion informacionin për situatën financiare të kësaj shoqërie nga viti 2012 e në vijim. Në ekstraktin historik të QKB-së *online* evidentohet se kjo shoqëri është regjistruar në datën 3.3.1998 dhe është themeluar në datën 30.11.2006, me nr. vendimi \*\*\*, të Gjykatës Tiranë. Më tej, në informacionin e vënë në dispozicion nga notere Dh.Q.<sup>30</sup>, konstatohet se akti i themelimit të shoqërisë mban datën 30.11.2006. Pra, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin N.T. është themeluar pas dhënies së huas në shumën 2.000 euro, subjektit të rivlerësimit.

#### **Analizimi i mundësisë financiare për pagimin e këstit të tretë në vlerën 5.000 euro**

**4.32.** Nga analiza financiare në datën 31.12.2007, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme në shumën 1.126.324 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

**4.33.** Komisioni, nisur faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar, në përputhje me ligjin në DPV-në e vitit 2006, detyrimin e lindur ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 5.000 euro; (ii) në lidhje me pagesën e këstit të parë në shumën 32.000 euro - nga analiza financiare në datën 12.10.2005, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në shumën 1.898.258 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive; (iii) në lidhje me pagesën e këstit të dytë në vlerën 23.000 euro - për shumën 3.000 euro nga kursimet: nga analiza financiare në datën 15.11.2006, duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe kryerjen e pagesës prej 3.000 euro për apartamentin; për shumën 20.000 euro, të marrë hua nga personat e tjerë të

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 27.10.2019.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 29.10.2019.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2020.

lidhur, mungon dokumentacioni ligjor për justifikimin e mundësisë financiare të këtyre personave për të dhënë hua pasi: për huan në vlerën 10.000 euro nga shtetasja Sh.K., subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion për të vërtetuar të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar, si dhe nga hetimi i Komisionit personi tjetër i lidhur nuk rezulton të ketë gjeneruar të ardhura para vitit 2006; për huan në vlerën 5.000 euro nga shtetasi Xh.K., dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti për të ardhurat e realizuara nga shitje pasurie e paluajtshme, daton pas vitit (viti 2006) të dhënies së huas; për huan 3.000 euro nga shtetasi E.S. (H.) dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, për të ardhurat e realizuara nga shitje pasurie e paluajtshme, daton pas vitit (viti 2006) të dhënies së huas; për huan në vlerën 2.000 euro nga shtetasi N.T., subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat, si dhe nga hetimi i Komisionit rezulton se shoqëria tregtare, ku ky shtetas është administrator dhe ortak i vetëm, është themeluar pas dhënies së huas (viti 2006); (iv) në lidhje me pagesën e këstit të tretë në vlerën 5.000 euro - nga analiza financiare në datën 31.12.2007, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme në shumën 1.126.324 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

**4.34.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: “[...] Për punimet e pakryera nga ‘\*\*\*’ sh.p.k., Komisioni nuk duhet të llogarisë vlerën 1.480 euro, pasi rregullimet për tualetin në hyrje të apartamentit me përmasa për afërsisht 1x1.3, nuk janë kryer në vitin 2007 dhe kanë kushtuar 20.000 lekë (shpenzimet për vendosjen e derës dhe pajisjeve)”. Subjekti nuk ka paguar për hakun e punës, pasi punimet janë kryer nga vëllai i tij, R.K., dhe shoku i fëmijërisë D.D., duke përmendur se pllakat e vendosura kanë tepruar nga ndërtimi i shtëpisë së vëllait. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme, subjekti depozitoi deklaratën që mban datën 30.6.2020, e nënshkruar nga vëllai i tij, R.K., dhe shoku i fëmijërisë D.D.

Sipas subjektit, ky apartament është blerë në vlerën 60.000 euro dhe jo 61.480 euro dhe se është i vetmi blerës në këtë ndërtesë që ka paguar një çmim kaq të shtrenjtë. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti paraqiti disa kontrata të lidhura në të njëjtin pallat<sup>31</sup>. Më tej, shprehet se pavarësisht harresës dhe mosdeklarimit të kursimeve vjetore të tij dhe të bashkëshortes për vitet 2004 – 2010, këto kursime kanë ekzistuar dhe me to janë paguar këstet dhe shlyer huat e marra. Gjithashtu, në deklarinimin fillestar të vitit 2003 ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.000.000 lekë, duke saktësuar se kjo shumë ka si burim të ardhurash kursimet në Francë, si dhe kursimet e tij dhe të bashkëshortes.

Në prapësime, subjekti ngriti pretendime edhe për përlogaritjen e shpenzimeve *TIMS* dhe mospërputhjeve në analizën financiare në datën 15.11.2006, me analizën financiare të pikës 12.1, që është analiza përmbledhëse, ku është përfshirë edhe viti 2006.

**4.35.** Lidhur me huan në shumën 10.000 euro nga kunata, subjekti deklaroi se baxhanaku i tij A.K. ka punuar në Minierën Përrenjas me pagë shumë të mirë për kohën, duke pasur mundësi për të kursyer. Pas viteve 1990, e deri më sot, është marrë me tregti me pakicë. Po kështu,

---

<sup>31</sup> Kontratat nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerës K.D., apartament me sip. 104.1 m<sup>2</sup>, blerë në shumën 36.435 euro; nr. \*\*\*, datë 31.12.2007, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerës E.Ç., apartament me sip. 104.12 m<sup>2</sup>, blerë në shumën 36.440 euro.

kunata e tij Sh.K. ka qenë e regjistruar me biznes privat dhe, aktualisht, zotëron disa pasuri të paluajtshme, të cilat e kalojnë disa herë shumën prej 10.000 euro, që subjekti ka marrë hua dhe e ka shlyer. Subjekti, në prapësime, paraqiti në cilësinë e provës<sup>32</sup> pagesën e sigurimeve për periudhën 1.3.2001 – 30.6.2008 dhe cilësoi se përgjigja e DRT –së Elbasan drejtuar Komisionit, ku citohej se Personi Fizik nuk ka deklaruar asnjë listëpagesë për sigurimet shoqërore, është e gabuar, pasi referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2020, të Bashkisë Përrenjas (një fletë), citohet se: *“Sh.K. ka qenë e regjistruar pranë organeve të qeverisjes vendore, Bashkia Përrenjas, me aktivitet: artikuj të ndryshëm industrialë, në Elbasan, Librazhd dhe Përrenjas. Ky subjekt është regjistruar në datën 13.1.2001 dhe është çregjistruar në datën 24.10.2008. Nga verifikimet e kryera pranë arkës së Bashkisë Përrenjas, rezulton se subjekti “Sh. K.”, Person Fizik, me nipt \*\*\*, ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për qarkullimin deri në shumën 2.000.000 lekë (biznes i vogël), sipas periudhave dhe përcaktimeve ligjore në fuqi për kohën e ushtrimit të aktivitetit, nga viti 2001 deri në vitin 2008”*. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti, gjithashtu deklaroi se bazuar në DPV-të vjetore, huaja në vlerën 10.000 euro është marrë në vitin 2006, ndërkohë që në aktekspertimin e realizuar nga ekspertja, dorëzuar nga subjekti, citohet: *“nga kunata për vitin 2006 është marrë fillimisht borxh gjysma e vlerës dhe diferenca prej 5.000 euro është marrë në vitin 2007”*.

**4.36.** Lidhur me huan në shumën 5.000 euro nga vëllai, Xh.K., subjekti deklaroi se vëllai i tij ka punuar: si kuzhinier në NSHN Librazhd dhe në hotel “\*\*\*\*” Librazhd; disa vite në lokalin e ndërtuar nga babai i subjektit në Librazhd; në \*\*\*, Halkidiki, Greqi, në një zonë turistike; si dhe pasi është shkëputur nga Greqia, vazhdon të punojë si kuzhinier në Tiranë. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi dokumentacion provues<sup>33</sup> që vërteton punësimin e vëllait të tij si punonjës në shtetin grek dhe një deklaratë (jo noteriale) të lëshuar nga shtetasi Xh.K., që mban datën 4.7.2020, ku, ndër të tjera, citohet se do të përpiqet të marrë akte të tjera nëpërmjet kontakteve me telefon, pasi është e pamundur lëvizja në shtetin grek për shkak të pandemisë Covid-19.

**4.37.** Lidhur me huan në shumën 3.000 euro, nga kunati, vëllai i bashkëshortes së subjektit, z. E.S. (H.), subjekti deklaroi se jeton dhe punon në Athinë, Greqi, që nga vitet 1990, së bashku me familjen e tij (bashkëshorten dhe dy fëmijët, të pajisur me pasaporta greke). Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi dokumentacion provues<sup>34</sup> për të ardhurat e tij.

---

<sup>32</sup> Vërtetim vjetërsie për personat fizikë, datë 1.7.2020, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Elbasan dhe vërtetim për bazën e vlerësuar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Elbasan.

<sup>33</sup> Fotokopje e dëshmisë së kualifikimit si kuzhinier, të mbaruar në Tiranë në vitet 1985 – 1986; fotokopje të pasaportës së vëllait Xh.K., së bashku me vizat e lëshuara nga ambasada greke në Tiranë; vërtetim datë 30.6.2003, i Drejtorisë së Punësimit, sektori i lejes së punës, për depozitimin e kërkesës për rinovimin e lejes së punës dhe lejes së qëndrimit, i përkthyer dhe i noterizuar; vërtetim datë 25.4.2002 i Administratës Vetqeverisëse, Prefektura Selanik, për depozitimin e kërkesës për rinovimin e lejes së punës dhe lejes së qëndrimit, i përkthyer dhe i noterizuar; shkresë shpallje punësimi (\*\*\*) datë 25.6.2003, që provon se është i punësuar me nr. tatimor \*\*\*, nr. leje \*\*\*, përshkrim pune “punëtor ndërtimi”, i përkthyer dhe i noterizuar; vërtetim nga punëdhënësi, i cili deklaroi se ka të punësuar shtetasin Xh.K. në pozicionin e punëtorit, i përkthyer dhe i noterizuar; kartë e Bankës Kombëtare të Greqisë, e përkthyer dhe e noterizuar; libër personal shëndeti e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega \*\*\*, datë 30.6.2003, i përkthyer dhe i noterizuar; dhe vërtetimi i librit personal të shëndetit, me nr. regjistri \*\*\*, nga data 1.3.2005 deri më 28.2.2006, i përkthyer dhe i noterizuar.

<sup>34</sup> (1) Pagesë sigurimesh shoqërore për vitin 1999; (2) ekstrakt i analizës financiare sipas sigurimeve; (3) ekstrakt personal i llogarisë së sigurimeve e të punësuarve në punë dhe projekte ndërtimi viti 3/1998; (4) ekstrakt personal i llogarisë së

**4.38.** Lidhur me huan në shumën 2.000 euro, subjekti dorëzoi një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.6.2020, të lëshuar nga shtetasi N.T. lidhur me këtë huadhënie, si dhe nxjerrje llogarie të këtij shtetasi në “Tirana Bank”, në lekë, për periudhën 1.1.2006 – 1.3.2006.

#### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**4.39.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**4.40.** Lidhur me përlllogaritjen e vlerës së punimeve të pakryera nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor provues pretendimet e tij në lidhje me shumën 20.000 lekë. Për këtë arsye, ky zë shpenzimesh mbeti i pandryshuar në analizën financiare.

**4.41.** Lidhur me pretendimin se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2004, ndërkohë, që në analizën financiare është pasqyruar gjendje zero, në datën 31.12.2004, Komisioni vëren se nëse merret parasysh ky pretendim, shuma prej 1.000.000 lekësh duhet mbartur deri në fund të vitit 2010, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar shtesa dhe pakësime të kësaj shume përgjatë këtyre viteve. Në vijim, efekti i vetëm në analizën financiare do të ishte vetëm në vitin 2004, ku ndryshimi i likuiditeteve nga -1.000.000 lekë do të bëhej 0 lekë, dhe balanca pozitive vjetore, nga 1.764.252 lekë do të bëhej 764.252 lekë, ndërsa për vitet në vazhdim nuk do të kishte efekte për sa kohë shuma prej 1.000.000 lekësh do të mbetej e pandryshueshme. Për më tepër, në pyetësin nr. 3, subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me gjendjen *cash* prej 1.000.000 lekësh dhe nuk e deklaroi këtë shumë si burim për pagesën e kështit të apartamentit, por deklaroi se nga përfundimi i studimeve në dhjetor të vitit 1997 deri në vitin 2010, të gjitha paratë i ka pasur *cash*, për shkak se ka bërë likuidimin e huave të marra borxh tek të tretët, hua të cilat janë shlyer, ndër vite, siç janë deklaruar në deklaratat përkatëse.

**4.42.** Lidhur me pretendimin e subjektit për shpenzimet *TIMS*<sup>35</sup>, konkretisht, të shumës 56.545 lekë në analizën financiare të datës 12.10.2005 dhe shumës 52.175 lekë në analizën financiare të datës 16.11.2006, Komisioni vëren se për vitin 2005, konkretisht, për periudhën 1.1.2005 – 12.10.2005, nuk janë llogaritur shpenzime gjatë trajnimeve siç pretendon subjekti, por vetëm shpenzime për udhëtimet e tjera me destinacion Greqinë, konkretisht, nga datat 5.7.2005-6.7.2005<sup>36</sup>; 16.7.2005-19.7.2005<sup>37</sup> dhe datë 8.10.2005<sup>38</sup>, ku bazuar në Aneksin 2, të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, janë përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit, kartoni jeshil dhe shuma prej 5 euro/ditë. Ndërkohë, për periudhën 1.1.2006-16.11.2006, Komisioni vëren se

---

sigurimeve e të punësuarve në punë dhe projekte ndërtimi viti 1/2001; (5) ekstrakt personal i llogarisë së sigurimeve e të punësuarve në punë dhe projekte ndërtimi viti 3/2001; (6) ekstrakt Enti i Përbashkët i Sigurimeve Shoqërore, vitet 2002-2020, [gjithsej 13 (trembëdhjetë) fletë, përkthyer dhe noterizuar];

<sup>35</sup> Subjektit i janë vendosur në dispozicion të gjitha lëvizjet e printuara nga sistemi *TIMS*, të tij dhe të familjarëve të tij.

<sup>36</sup> Sipas deklaramit, destinacioni ka qenë te djali i xhaxhait D.K., \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, Selanik, Greqi,

<sup>37</sup> Sipas deklaramit të subjektit, destinacioni ka qenë kushëriri i tij G.Gj., A.N., Halkidiki, Greqi, ku subjekti ka udhëtuar së bashku me bashkëshorten

<sup>38</sup> Sipas deklaramit, destinacioni ka qenë te djali i xhaxhait D.K., \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, Selanik, Greqi

janë përlllogaritur shpenzime për udhëtimet e datave me destinacion Greqinë, konkretisht, datë 22.4.2006-24.4.2006<sup>39</sup>; datë 26.8.2006<sup>40</sup> dhe për udhëtimin në Itali datë 23.9.2006-26.9.2006<sup>41</sup> nuk është marrë në konsideratë deklarata e shtetasit B.V., për sa kohë nuk ishte vetë pritësi dhe përlllogaritjet për biletën dhe shpenzimet e qëndrimit janë bërë bazuar në metodikën e analizës financiare (Aneks 2).

**4.43.** Për sa i përket pretendimit të subjektit se shpenzimet për pushime vjetore brenda vendit dhe shpenzime për automjete përfshihen te shpenzimet vjetore jetike, Komisioni, duke marrë në analizë “Klasifikimin e Konsumit Individual sipas Qëllimit” (COICOP) publikuar nga INSTAT-i për vitet 2014, 2015, dhe 2016, konstaton se në rastin konkret, përqindja e zërit “transporte” dhe “restorante dhe hotele” është më e lartë se përqindja që zënë shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni për pushime vjetore dhe automjete në raport me shpenzimet jetike dhe, për këtë arsye, u konsiderua pretendimi i subjektit.

**4.44.** Lidhur me pretendimin e subjektit për rezultatin e datës 15.11.2006, në krahasim me rezultatin e datës 31.12.2006, Komisioni vëren se në paragrafin 4.25 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, është shprehur qartazi se analiza e datës 15.11.2006 ka si objekt analizimin e burimit, vetëm për shumën 3.000 euro nga kursimet, ndërsa në analizën vjetore përfshihet pagesa e plotë e këstit prej 23.000 euro të paguar për apartamentin, për të cilën subjekti ka deklaruar si burim shumën 3.000 euro kursime dhe shumën 20.000 euro hua.

#### **Lidhur me huan në shumën 10.000 euro nga kunata, znj. Sh.K.**

**4.45.** Referuar DPV-së së vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua vlerën prej 10.000 euro në vitin 2006, ndërkohë, në aktekspertimin e realizuar nga ekspertja, dorëzuar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, citohet: “nga kunata për vitin 2006 është marrë fillimisht borxh gjysma e vlerës dhe diferenca prej 5.000 euro është marrë në vitin 2007”. Lidhur me këtë deklaram, subjekti u pyet në seancën dëgjimore të datës 16.7.2020, ku deklaroi se huaja nga kunata është marrë në vlerat 5.000 euro në vitin 2006 dhe 5.000 euro në vitin 2007. Për sa rezulton, Komisioni konstaton se subjekti ka ndryshuar deklaram pas kalimit të barrës së provës, pasi ky fakt nuk është pretenduar gjatë hetimit dhe nuk është deklaruar në DPV-të e viteve 2006 dhe 2007.

**4.46.** Komisioni analizoi të ardhurat e subjektit “Sh.K.” Person Fizik, nga marsi i vitit 2001 deri në tetor të viti 2006<sup>42</sup>. Bazuar në natyrën e aktivitetit dhe rajonin ku zhvillohet, si dhe qëndrimeve të mëparshme të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se shuma e fitimit *neto* nga aktiviteti tregtar, të përlllogaritet 20 % e qarkullimit, për të cilin janë paguar detyrimet tatimore përkatëse, të konfirmuara nga organet tatimore. Nga kjo analizë, duke mos marrë në konsideratë investimet që mund të jenë kryer nga personi tjetër i lidhur, rezulton se shuma e fitimit *neto* është pothuajse e barabartë me shpenzimet jetike për 4 persona<sup>43</sup> dhe, për rrjedhojë,

<sup>39</sup> Sipas deklaramit, destinacioni ka qenë te vëllai Q.K., në adresën: A.P., \*\*\*, T. K. \*\*\*, Athinë.

<sup>40</sup> Sipas deklaramit, destinacioni ka qenë te djali i xhaxhait D.K., në adresën: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, Selanik, Greqi.

<sup>41</sup> Sipas deklaramit të subjektit, destinacioni ka qenë në \*\*\*, Itali, te miku i tij italian, z. M.C.

<sup>42</sup> Qarkullim total në vlerën 11.333.333 lekë.

<sup>43</sup> Bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së, shpenzimet jetike për 4 persona për periudhën mars 2001 – tetor 2006 u përlllogariten në shumën 2.289.786 lekë.

Komisioni çmon se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mjete financiare të ligjshme, që mund të shërbenin për huan në shumën 10.000 euro, në vitin 2006.

#### **Lidhur me huan në shumën 5.000 euro nga vëllai, z. Xh.K.**

**4.47.** Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. Xh.K., sipas detyrimit të parashikuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**4.48.** Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, referuar pikës 4.36, provon vetëm punësimin në shtetin grek, por jo të ardhurat *neto* të realizuara, me qëllim përlllogaritjen nga Komisioni të mundësisë financiare për të dhënë hua shumën 5.000 euro.

**4.49.** Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe si rezultat, burimi i krijimit të apartamentit për shumën 5.000 euro, të deklaruar si të marrë hua nga vëllai, nuk u mor në konsideratë në analizën financiare.

**4.50.** Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit, të përfituara nga personi tjetër i lidhur, në vitin 2008 (ndërkohë që huaja ishte marrë në vitin 2006), subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë shpjegim pas kalimit të barrës së provës dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk u morën në vlerësim nga Komisioni gjatë analizimit të mundësive financiare të huadhënësit.

**4.51.** Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave të ligjshme për shumën prej 5.000 euro.

#### **Lidhur me huan në shumën 3.000 euro nga kunati/vëllai i bashkëshortes/E.S. (H.)**

**4.52.** Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, referuar pikës 4.37, Komisioni analizoi të ardhurat e këtij shtetasi për periudhën 1998 – 2006, të cilat rezultojnë në shumën 38.025 euro<sup>44</sup>, ndërsa shpenzimet jetike vetëm për një person në shumën 41.487 euro<sup>45</sup>.

**4.53.** Nga kjo analizë, duke mos marrë në konsideratë investimet që mund të jenë kryer nga personi tjetër i lidhur, rezultojnë se shumica e të ardhurave është më e vogël se shpenzimet jetike dhe, për rrjedhojë, Komisioni çmon se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mjete financiare të ligjshme që mund të shërbenin për huan në shumën 3.000 euro, në vitin 2006.

**4.54.** Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit, të përfituara nga personi tjetër i lidhur, në vitin 2010 (ndërkohë që huaja ishte marrë në vitin 2006), subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë shpjegim pas kalimit të barrës së provës dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk u morën në vlerësim nga Komisioni gjatë analizimit të mundësive financiare të huadhënësit.

---

<sup>44</sup> Për vitin 1998, të ardhura në vlerën 1.034 euro si ekuivalent i 297.500 GRD, kurs këmbimi Banka e Shqipërisë, 100 GRD = 51.07 lekë dhe 1 euro = 146.96 lekë; për vitin 1999 të ardhura në vlerën 3.740 euro si ekuivalent i 1.221.300 GRD, kurs këmbimi 100 GRD = 45 lekë dhe 1 euro = 146.96 lekë; për vitin 2000 të ardhura në vlerën 2.960 euro; për vitin 2001 të ardhura 2.558 euro; për vitin 2002 të ardhura në vlerën 5.026 euro; për vitin 2003 të ardhura në vlerën 7.835 euro; për vitin 2004 të ardhura në vlerën 4.648 euro; për vitin 2005 të ardhura në vlerën 4.910 euro; për vitin 2006 të ardhura në vlerën 5.315 euro.

<sup>45</sup> <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>



**4.55.** Në konkluzion, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. E.S. (H.), sipas detyrimit të parashikuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**4.56.** Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe si rezultat burimi i krijimit të partamentit për shumën 3.000 euro të deklaruar si të marrë hua nga personi tjetër i lidhur/z. E.S. (H.), nuk u mor në konsideratë në analizë financiare.

#### **Lidhur me huan në shumën 2.000 euro nga personi tjetër i lidhur/N.T.**

**4.57.** Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, referuar pikës 4.38, Komisioni konstaton se në lëvizjet e llogarive të mësipërme evidentohet: (1) transfertë datë 23.1.2006, nga Union Distribution me përshkrim “kom. shitje telbota dhjetor-05”, shuma 304.550 lekë; dhe (2) depozitime nga ky shtetas dhe persona të tretë, që variojnë nga shuma 486.100 lekë deri në shumën 3.062.500 lekë.

**4.58.** Komisioni çmon se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk provon ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rezultat, burimi i krijimit të apartamentit për shumën 2.000 euro, të deklaruar si të marrë hua nga personi tjetër i lidhur/N.T., nuk u mor në konsideratë në analizën financiare.

**4.59.** Në përfundim të analizës për këto hua, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave në vlerën 20.000 euro dhe kjo përbën mospërmbushje të detyrimit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**4.60.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në kuadër të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin jo vetëm të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tyre, por edhe të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve të tyre për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këtë kuptim, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimeve, shpjegimeve dhe provave të dorëzuara gjatë prapësimeve, subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

#### **5. Apartament me sip. 131.71 m<sup>2</sup>, në vlerën 60.000 euro, në Tiranë**

**5.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka lidhur kontratën me kusht nr. \*\*\*, datë 5.6.2015, për blerje apartamenti në Tiranë, nga shitësit D. dhe S.Xh., në shumën 60.000 euro, paguar vlerën 2.500.000 lekë ose 17.850 euro, sipas xhimit bankar të “Raiffeisen Bank”, datë 5.5.2015. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi për blerjen e

apartamentit, subjekti deklaron kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>46</sup>.

**5.2.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron likuidimin e shumës 42.150 euro për blerjen e këtij apartamenti në zbatim të kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 5.6.2015.

**5.3.** Nga hetimi i Komisionit, bazuar në dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>47</sup>, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi apartamentin me sip. 131.71 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, vërtetuar me kartelën e pasurisë datë 5.11.2019. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitjeje me kusht nr. \*\*\*, datë 5.6.2015, me palë shitëse shtetasit D. dhe S.Xh., për blerjen e këtij apartamenti, të ndodhur te diga e liqenit, Tiranë, me vlerë 60.000 euro. Subjekti ka parapaguar shumën prej 2.500.000 lekësh, datë 5.5.2015, në llogarinë bankare të shitësit, konfirmuar me transfertën bankare të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, shuma e mbetur e konvertuar në vlerën 42.150 euro do të fiksohet me deklaratë noteriale. Sipas prokurës së përgjithshme nr. \*\*\*, datë 2.6.2015, shtetasit D. dhe S.Xh. kanë caktuar përfaqësues ligjor z. E.Xh. për kryerjen e veprimeve të ndryshme ligjore në emër dhe për llogari të tyre<sup>48</sup>.

**5.4.** Nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>49</sup>, rezulton se në datën 5.5.2015, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit, është transferuar shuma prej 2.500.000 lekësh në llogarinë e shtetasit D.Xh. me përshkrim “paguar këst për blerje apartamenti”. Konstatohet se kjo shumë e ka burimin nga *maturimi* i depozitës/depozitave të krijuara ndër vite. Rritja e depozitës nga viti 2012 në vitin 2013 e ka burimin nga kalimi i shumës 650.000 lekë nga llogaria e bashkëshortes te llogaria e subjektit, shumë e cila vjen nga pagat dhe një depozitim në vlerën 250.000 lekë, në llogarinë e bashkëshortes në datën 25.2.2013. Gjendja *cash* në fund të vitit 2012, bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, ka qenë në vlerën 800.000 lekë. Rritja e depozitës nga viti 2013 në vitin 2014 e ka burimin nga depozitimi *cash* i shumës 400.000 lekë, në datën 25.2.2014. Gjendja *cash* në fund të vitit 2013, bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore ka qenë në vlerën 400.000 lekë. Rritja e depozitës nga viti 2014 në vitin 2015 e ka burimin nga depozitimi *cash* i shumës 800.000 lekë, në datën 24.2.2015. Gjendja *cash* në fund të vitit 2014, bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, ka qenë në vlerën 800.000 lekë. Mundësitë financiare të krijimit të këtyre depozitave u paraqitën në analizën financiare ndër vite<sup>50</sup>.

**5.5.** Referuar deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 14.11.2017, shtetasit D. dhe S.Xh. kanë deklaruar likuidimin e kështit të dytë prej 42.150 euro, sipas mandatit bankar bashkëlidhur. Me likuidimin e kështit të dytë, blerësi do të pajiset me certifikatën dhe kartelën e pasurisë së lirë

---

<sup>46</sup>Kontratë shitje me kusht nr. \*\*\*, datë 5.6.2015, me palë shitëse D. e S.Xh. dhe palë blerëse Selim Kryeziu, certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 5.5.2015, njoftim debitimi në “Raiffeisen Bank”, datë 5.5.2015, ku shtetasi Selim Kryeziu i kalon shtetasit D.Xh. shumën prej 2.500.000 lekësh.

<sup>47</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2018, që gjendet e administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 27.10.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>50</sup> Pika \*\*\*.

nga çdo barrë dhe hipotekë. Nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>51</sup>, rezulton se në datën 14.11.2017, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma prej 42.150 euro në llogarinë e noteres M.Sh. me përshkrim “pagesë për blerje apartamenti sipas kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2015”. Konstatohet se kjo shumë e ka burimin nga shuma 75.000 euro, e përfituar nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*\*” (trajtuar më sipër).

**5.6.** Sipas kartelës së pasurisë në emër të shtetasit D.Xh., rezulton se ky apartament është blerë në shumën 48.733 euro me shënimin “\*\*\*\*, datë 30.11.2007”. Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2018, që gjendet e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se llogaritja e tatim-fitimit, për këtë apartament, është bërë sipas çmimit të kontratës së shitjes në vlerën 8.001.000 lekë, ndërkohë që çmimi i mëparshëm ose sipas RVP-së (çmim tregu) të kësaj pasurie është në shumën 14.092.970 lekë. Komisioni vëren se është bërë rivlerësimi i kësaj pasurie në datën 26.11.2016 dhe diferenca për t’u paguar është 0 lekë.

**5.7.** Për sa më sipër, duke qenë se ky apartament ndodhet në një nga zonat e preferuara të Tiranës dhe vlera e tregut të kësaj pasurie sipas ZVRPP-së Tiranë është në vlerën 14.092.970 lekë, me pyetësin nr. 2, subjektit iu kërkua të shpjegojë përfitimin e këtij apartamenti me çmim preferencial dhe përse nuk është deklaruar në deklaratat periodike apo në deklaratën *Vetting* ky trajtim preferencial, si dhe marrëdhënia e subjektit me shitësit. Në përgjigje të pyetësit<sup>52</sup>, subjekti deklaroi se nuk ka trajtim preferencial në blerjen e këtij apartamenti. Pala shitëse, këtë apartament, e ka blerë në shumën 48.733 euro dhe e ka shitur në shumën 60.000 euro, për shkak të emigrimit familjarisht në SHBA, me llotari amerikane. Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit ka miqësi të ngushtë me znj. S.Xh. dhe si rezultat edhe subjekti ka miqësi me z. D.Xh. Më tej, subjekti sqaron se shitësit D. dhe S.Xh. zotërojnë pasuri të tjera të paluajtshme në Tiranë dhe këtë apartament nuk dëshironin ta shisnin te persona të tjerë, pasi zotërojnë një apartament tjetër te h. \*\*\* e këtij pallati dhe kanë menduar që pensionin ta kalojnë në Tiranë, duke qenë afër me familjen e subjektit. Më tej, me pyetësin nr. 4, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar që të provojë me dokumentacion deklaratimet e tij në lidhje me emigrimin dhe zotërimin e një apartamenti tjetër nga personat e tjerë të lidhur, si dhe kontratën e origjinës së apartamentit me sip. 131.71 m<sup>2</sup>. Në përgjigje, subjekti ka dorëzuar: (i) deklaratë (jo-noteriale) nga shtetasit D. dhe S.Xh., ku deklarohen se kanë banuar në apartamentin me sip. 131.71 m<sup>2</sup>, i kompletuar, pranë Digës së Liqenit gjatë periudhës shkurt 2008 – 15.6.2015; (ii) kontratë shitjeje nr. \*\*\*\*, datë 19.12.2008, lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*\*” dhe shtetasit D.Xh., me objekt apartament nr. \*\*\*\*, kulla \*\*\*\*, k. \*\*\*\*, h. \*\*\*\*, me sip. 68.55 m<sup>2</sup>; (iii) kopje të pasaportave ku evidentohet viza për emigrim me kategori DV dhe kopje të lejes së drejtimit nga shteti i Ohio-s; (iv) kontratë shitjeje nr. \*\*\*\*, datë 30.11.2007, lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*\*” dhe shtetasit D.Xh., me objekt apartament nr. \*\*\*\*, kulla \*\*\*\*, k. \*\*\*\*, h. \*\*\*\*, me sip. 131.71 m<sup>2</sup>, në vlerën 48.732,7 lekë.

**5.8.** Në lidhje me pagesën e këstit prej 2.500.000 lekësh, nga analiza financiare e vitit 2015, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\*\*, datë 27.10.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>52</sup> Protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\*\*, datë 25.2.2020.

shpenzimeve dhe blerjen e pasurive. Gjithashtu, në lidhje me pagesën e këstit prej 42.150 euro, Komisioni konstatoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, duke qenë se burim i kësaj shume janë të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*”.

**5.9.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me çmimin preferencial të blerjes së këtij apartamenti në vlerë 60.000 euro, krahasuar me vlerën e tregut dhe çmimin e rivlerësimit në shumën 14.092.970 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, shpjegoi duke deklaruar se: “[...] shitësit e apartamentit, disponojnë edhe disa pasuri të tjera në Republikën e Shqipërisë, po ashtu ata jetojnë në SHBA, ku kanë blerë edhe shtëpinë e tyre private, fakt i provuar me provat e dërguara më parë gjatë hetimit”.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**5.10.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se subjekti arriti të shpjegoi bindshëm çmimin e blerjes së këtij apartamenti në vlerë 60.000 euro.

## **6. Automjet tip “Mercedes Benz” me targa \*\*\*, në vlerë 200.000 lekë**

**6.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz 124”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, te shitësi J.K., nipi i baxhanakut të tij, z. A.K., në vlerën 200.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Më tej, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “... shitur kjo autoveturë me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.8.2013, A.D. në vlerën 300.000 lekë”. Pjesa takuese: 50 %. Burim krijimi: kursimet familjare. Për vërtetimin e deklaratimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>53</sup>.

**6.2.** Nga hetimi i Komisionit, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2117, të DPSHTRr-së, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, konstatohet se subjekti ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, deri në datën 9.10.2013. Ky automjet është blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, me palë shitëse, z. J.K., nipi i baxhanakut të subjektit, në vlerën 200.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më tej, me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.8.2013, subjekti ia ka shitur këtë automjet palës blerëse, z. A.D., në vlerën 300.000 lekë, likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale.<sup>54</sup> Nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2013.

**6.3.** Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV-në e vitit 2005 dhe as në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës në vitin 2006. Në

---

<sup>53</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, me palë shitëse J.K. dhe palë blerëse Selim Kryeziu, kontratë shitblerjeje \*\*\*, datë 9.8.2013, me palë shitëse Selim Kryeziu dhe palë blerëse A.D.

<sup>54</sup> Mundësia financiare për blerjen e këtij automjeti u trajtua në pikën \*\*\* të analizës financiare, viti 2005.

DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaroi blerje automjeti tip “Mercedes Benz”, prodhim i vitit 1988, me targa \*\*\*, në vlerën 200.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2013, deklaroi shitje automjeti tip “Mercedes Benz” sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 9.8.2013, në vlerën 300.000 lekë. Ky automjet rezultoi se është shitur pas 8 vjetësh në vlerë më të lartë se ajo e blerjes, duke llogaritur vitin e prodhimit dhe koston e amortizimit të mjetit.

**6.4.** Për sa më sipër, me pyetësin nr. 2, subjektit iu kërkua të shpjegojë faktin e rritjes së vlerës së këtij automjeti me 50 %, pas 8 vjetësh përdorim. Në përgjigje të pyetësit<sup>55</sup>, subjekti deklaroi se ky automjet është blerë nën vlerën e tregut, pasi do të blihej nga baxhanaku i tij, z. A.K., por për shkak se ky i fundit e kishte një automjet, është kërkuar nga subjekti ta blejë, duke qenë se nuk zotëronte një të tillë. Duke qenë se ky automjet i ishte premtuar z. A.K. në këtë çmim, nën vlerën e tregut, në të njëjtin çmim iu la edhe subjektit. Në lidhje me çmimin e shitjes, subjekti deklaroi se duke qenë se banonte në Tiranë dhe punonte në KLD, përdorimi i automjetit nuk ishte i nevojshëm dhe e ka përdorur shumë pak, si dhe deklaroi se ia kishte lënë z. A.K. automjetin për shitje (duke i thënë shite sa të duash) dhe blerësi është gjetur nga ky i fundit, subjekti deklaroi se nuk e njihte blerësin dhe se çmimi i shitjes është vendosur prej tyre.

**6.5.** Komisioni vëren se për sa kohë duket se nuk janë paguar detyrimet tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca në shumën prej 100.000 lekësh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes), vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar.<sup>56</sup>

**6.6.** Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se: (i) subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit blerjen e automjetit në DPV-në e vitit 2005 dhe as në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës në vitin 2006; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit në shumën 100.000 lekë.

**6.7.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: “[...] në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, pika 4, e nenit 13 të tij, individët nën kufirin 2 milionë lekë në vit, janë të përjashtuar nga plotësimi dhe dorëzimi i deklaratës vjetore për të ardhurat e realizuara. Nga interesimi pranë noterëve dhe organeve tatimore, asnjë shtetas, individ rezident nuk ka pasur dhe nuk e ka detyrim pagesën e tatimit mbi të ardhurat si në rastin e shitjes së automjetit me një fitim prej 100.000 lekësh, pasi të ardhurat e realizuara nuk e kalojnë kufirin e 2 milionë lekëve në vit. Për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar në shumën 100.000 lekë duhet të vlerësohet si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihet në tabelën financiare.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

<sup>55</sup> Protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020.

<sup>56</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**6.8.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**6.9.** Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga shitja e automjetit, Komisioni, në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj dhe për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, bazuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit.

**6.10.** Si konkluzion, shuma prej 100.000 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare.

## **7. Automjet tip “Mercedes Benz” me targa \*\*\*, në vlerën 5.000 euro.**

**7.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë autoveturë tip “Mercedes Benz 211”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, te shitësi E.Rr. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet familjare. Subjekti, për vërtetimin e deklaratimeve të tij, paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>57</sup>.

**7.2.** Nga hetimi i Komisionit, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2017, të DPSHTRr-së, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, u konstatua se subjekti ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, deri më 13.4.2017. Automjeti tip “Mercedes Benz Daimlerchrysler E 270 CDI”, është blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, me palë shitëse, z. E.Rr., në vlerën 5.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga kontrolli i kryer në AMF, rezultoi se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit nga viti 2013 deri më 2017.

**7.3.** Nga analiza financiare e vitit 2015, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive gjatë vitit 2015.

**7.4.** Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi këtë pasuri dhe ka burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

## **8. Llogaritë bankare në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së tij**

**8.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: (1) gjendje në lekë në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 212.562 lekë. Pjesa takuese: 50 %; (2) gjendje në euro në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 21 euro. Pjesa takuese: 50 %; (3) gjendje në

---

<sup>57</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, me palë shitëse E.Rr. dhe palë blerëse Selim Kryeziu, certifikatë pronësie e automjetit tip “Daimlerchrysler E 270 CDI”, me targa \*\*\*.

lekë në llogarinë e bashkëshortes, në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 151.815 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>58</sup>.

**8.2.** Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>59</sup>, konfirmohen llogaritë rrjedhëse në emër të subjektit, në valutën lekë dhe euro, si dhe llogari page në emër të bashkëshortes së tij në valutën lekë.

**8.3.** Në konkluzion, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

## **9. Konstatime të tjera gjatë hetimit**

**9.1.** Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja<sup>60</sup> rezulton se në emër të subjektit është i regjistruar automjeti me targa \*\*\*. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, rezultoi se ky automjet është në pronësi të subjektit të rivlerësimit, i cili me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.4.2017, ka blerë nga shtetasi K.S. një automjet të tipit “Volkswagen” me targa \*\*\*, në shumën 8.000 euro.

**9.2.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerje autoveture tip “Volkswagen Tiguan” në shumën 8.000 euro nga shtetasi K.S. sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 8.4.2017. Gjithashtu, u konstatua se ky automjet është blerë nga shtetasi K.S. në vlerën 8.000 euro, shpenzimet e transportit janë në shumën 40.758 lekë dhe shpenzimet doganore në shumën 252.421 lekë, si dhe zhdoganuar në datën 22.12.2016. Komisioni kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave<sup>61</sup>, lidhur me importet e kryera, ndër vite, nga shtetasi K.S. për të kuptuar nëse ky shtetas tregtonte automjete. Në përgjigje të saj, DPD-ja informon se gjatë viteve 2016 – 2017 nga ky shtetas janë zhdoganuar 8 automjete.

**9.3.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive gjatë vitit 2017.

**9.4.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se duket i dyshimtë çmimi i blerjes së automjetit, pasi shtetasi K.S., i cili duket se merret me tregti automjetesh, e ka shitur me të njëjtin çmim që e ka blerë në Gjermani (8.000 euro), duke mos i shtuar çmimit të shitjes as shpenzimet doganore dhe të transportit (në total 293.179 lekë) dhe as ndonjë fitim të mundshëm, konsideruar këtu edhe periudhën e shkurtër 4-mujore, që nga data e blerjes deri në datën e shitjes.

**9.5.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: “[...] ky mjet ka rezultuar me defekte dhe i është dashur t’i riparojë ato për

---

<sup>58</sup>Nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank” datë 11.10.2016; gjendja e llogarisë së pagës në datën 30.9.2016, në vlerën 156.849 lekë, nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank” datë 14.10.2016; gjendja e llogarisë në datën 29.9.2008, në vlerën 21 euro, nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”, datë 24.10.2016; gjendja e llogarisë së pagës në datën 4.10.2016, në vlerën 151.815 lekë.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2019.

<sup>60</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019.

<sup>61</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2020.

ta bërë mjetin funksional”<sup>62</sup>. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti dorëzoi një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.6.2020, lëshuar nga shtetasi K.S., i cili shprehet se këtë mjet e ka marrë me pëlqimin e tij me defekte, me mendimin se do ta riparonte me kosto të lirë, gjë, e cila nuk mund të kryhej dhe vendosi ta shiste me çmim më të ulët nga ai që e kishte porositur.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**9.6.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**9.7.** Komisioni vlerëson se duke qenë se subjekti e ka blerë këtë automjet në datën 8.4.2017 dhe më tej ka kryer udhëtime jashtë Shqipërisë, respektivisht: (i) në datën 13.5.2017 ka udhëtuar drejt Strugës; (ii) në datën 21.5.2017 ka udhëtuar drejt Shkupit; (iii) në datën 23.9.2017 ka udhëtuar drejt Ulqinit, si dhe udhëtime të tjera gjatë vitit 2018, tregon se automjeti ka qenë në gjendje funksionale, çka rrëzon pretendimet e subjektit. Pretendimet e shtetasit K.S. në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 23.6.2020 se automjeti është blerë me defekte, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivel deklarativ. Komisioni vlerëson se kjo deklaratë noteriale është e vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, por krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhojë, nuk mund të kenë efekt bindës në këtë proces.

**9.8.** Si konkluzion, Komisioni, bazuar në kriteret e pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>63</sup>, vlerëson se deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij. Marrja me rezervë e kësaj deklarate noteriale forcohet sidomos me faktin se nuk mbështetet dhe nuk është në harmoni me provat dhe faktet e përmendura më sipër, administruar gjatë hetimit.

**9.9.** Më tej, nga hetimi i Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja<sup>64</sup>, rezultoi se në emër të personit të lidhur, z. I.K. (djali i subjektit), është i regjistruar automjeti me targa \*\*\*. Shitësi B.M. deklaroi se i ka shitur z. I.K. automjetin tip “Daimlerchrysler C 200 CDI”, viti i prodhimit 2005, në vlerën 2.400 euro, sipas faturës tatimore. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se ky automjet është blerë në vlerën 900 euro + shpenzimet doganore në shumën 73.099 lekë, zhdoganuar në datën 29.11.2018. Ky automjet figuron i regjistruar në emër të personit të lidhur, z. I.K., në datën 8.4.2019. Nga kontrolli i kryer në AMF, rezultoi se ky automjet është në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>62</sup> Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, paraqiti disa foto për të provuar defektet e rënda të konstatuara në automjet pas blerjes.

<sup>63</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 12.9.2018, paragrafët \*\*\* dhe \*\*\*; vendimi nr. \*\*\*, datë 22.5.2019, paragrafi \*\*\*; vendimi nr. \*\*\*, datë 2.12.2019, paragrafi \*\*\*; vendimi nr. \*\*\*, datë 27.2.2020, paragrafi \*\*\*.

<sup>64</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019.



**9.10.** Referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>65</sup>, rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit janë të regjistruara 2 pasuri të llojit garazh, secila me sip. 30.47 m<sup>2</sup>, vërtetuar me kartelat e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. \*\*\*, datë 28.3.2018, me palë shitëse A.R., ka blerë pronat: (1) garazh me sip. 30.47 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me vendndodhje në digën e liqenit, Tiranë. Vlera: 8.000 euro; (2) garazh me sip. 30.47 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me vendndodhje në digën e liqenit, Tiranë. Vlera: 8.000 euro. Çmimi total i kontratës është në vlerën 16.000 euro, e cila ka kaluar në numrin e llogarisë së noteres Dh.Q., në BKT, në datën 28.3.2018, shuma të cilat e kanë burimin nga një depozitim në vlerën 38.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim “derdhje në llogari, tërheqje nga “Raiffeisen Bank meqenëse nuk ka llogari në valutë”<sup>66</sup>. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet tërheqja *cash* në datën, në vlerën 38.000 euro.

**9.11.** Nga analiza financiare e vitit 2018, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, pasi burim i kësaj shume janë të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*”.

**9.12.** Në deklaratën periodike të vitit 2017, subjekti ka deklaruar dhuratë nga babai shumë prej 500.000 lekësh nga shpronësimi i lokalit të tij në Librazhd. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”, në datën 9.1.2017, është transferuar në llogarinë e babait të subjektit të rivlerësimit vlera prej 2.802.000 lekësh, nga shtetasja E.Z. PF me përshkrim “ekzekutim i pjesshëm vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.5.2002” dhe në datën 10.1.2017 është transferuar shuma prej 500.000 lekësh, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit.

## **10. Në lidhje me të ardhurat si ekspert në Brindisi, Itali**

**10.1.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesë si ekspert në Brindisi, Itali, në vitin 2008, sipas nxjerrjes së llogarisë nga “Raiffeisen Bank” në vlerën 1.197 euro. Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar shpërblim nga Dhoma e Tregtisë së Brindisit, Itali, i ftuar në cilësinë e ekspertit në prill të vitit 2008, në vlerën 1.000 euro.

**10.2.** Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma 1.106,70 euro (dhe jo 1.197 euro) në datën 17.6.2008, nga I.S.F.O.R.E.S. ISTITUTO SUPERIORE me përshkrimin “compenso docenza e rimborso spese corso guida storico culturale naturalistica”. Referuar këtij përshkrimi, Komisioni vëren se shuma e transferuar ka të bëjë jo vetëm me pagesën për mësimdhënie, por edhe me kompensim shpenzimesh.

**10.3.** Duke iu referuar legjislacionin tatimor mbi të ardhurat personale, konkretisht, nenit 3 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe pikës 1.3 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, subjekti i rivlerësimit vlerësohet si “rezident tatimor shqiptar”, pasi përmbush kriterin e kohëzgjatjes së qëndrimit në Shqipëri për më shumë se 183 ditë gjatë vitit tatimor objekt shqyrtimi (viti 2008). Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit vlerësohet se ka qenë subjekt detyrimesh tatimore mbi

<sup>65</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019.

<sup>66</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2019.

të ardhurat personale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, me të vetmen rezervë rastet kur janë të zbatueshme marrëveshje ndërkombëtare për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit fiskal. Në rastin konkret, pas verifikimit në faqen zyrtare të organit tatimor<sup>67</sup>, evidentohet Konventa ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat, mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal.

**10.4.** Referuar nenit 14 të kësaj Konvente, Komisioni vëren se shërbimi i ofruar nga subjekti i rivlerësimit, përfshihet në pikën nr. 2<sup>68</sup> të kësaj konvente dhe se duhet të kishte paguar detyrimet tatimore në Shqipëri, për sa kohë nuk plotëson rrethanat e cituara në pikën 1<sup>69</sup>.

**10.5.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me faktin se nuk ka dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri dhe se mbart detyrimin të provojë se ky tatim është paguar në shtetin italian.

**10.6.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: “[...] bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, neni 8, ‘E ardhura e tatueshme’, mbartin detyrimin e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga individët rezidentë vetëm ata, të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit”. Gjithashtu, subjekti kërkoi të merren në konsideratë përcaktimet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84 /2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”*. Kjo pasi subjekti e ka të pamundur të marrë përgjigje nga shteti italian për të provuar nëse tatimi është mbajtur në burim apo jo, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19.

## **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**10.7.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave

<sup>67</sup> [www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare](http://www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare)

<sup>68</sup>Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

<sup>69</sup> Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një shteti kontraktues, lidhur me shërbimet profesionale ose aktivitetet e tjera të një karakteri të pavarur do të taten vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat që vijojnë, kur të tilla të ardhura mund të taten gjithashtu në shtetin tjetër kontraktues: (a) kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në shtetin tjetër kontraktues për kryerjen e aktiviteteve të tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të taten në shtetin tjetër; ose (b) kur ai qëndron në shtetin tjetër kontraktues për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; në këtë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër mund të taten në atë shtet tjetër.

periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

**10.8.** Lidhur me pretendimin e subjektit se referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8, “E ardhura e tatueshme”, mbartin detyrimin e deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga individët rezidentë vetëm ata të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit, Komisioni vëren se kjo kërkesë ligjore ka të bëjë me detyrimin për deklarim, ndërkohë që detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura është i mirëpërcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ku kjo e ardhur konsiderohet si e ardhur e tatueshme.

**10.9.** Për sa kohë nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar, vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe si konkluzion, shuma prej 1.106,70 euro, nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare.

## **11. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit**

**11.1.** Në pyetësin nr. 1, subjekti ka deklaruar: shpenzimet për mobilimin e apartamentit në Librazhd (1+1 me sip. 40.4 m<sup>2</sup>), duke përfshirë edhe pajisjet elektrike, nuk e kanë kaluar vlerën 250.000 lekë, shpenzime të bëra gjatë viteve. Punimet në këtë apartament, janë kryer nga baxhanaku i subjektit, z. B.K., pa pagesë. Komisioni vlerëson se këto shpjegime janë në nivel deklarativ dhe se subjekti nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar deklaratimet e tij. Megjithatë, duke pasur parasysh sipërfaqen dhe qytetin në të cilin ndodhej apartamenti, duket se shuma e deklaruar është e arsyeshme.

**11.2.** Shpenzimet për mobilimin e apartamentit me vendndodhje në Rr. “\*\*\*”, duke përfshirë edhe pajisjet elektrike, janë realizuar në një periudhë 10-vjeçare në vlerën rreth 500.000 lekë, si dhe deklaracion marrjen e dhuratave nga të afërmit dhe miqtë në vlerë mbi 10.000 lekë. Gjithashtu, subjekti deklaracion se nuk ka paguar për punët e kryera në këtë apartament. Komisioni vlerëson se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në fund të tetorit të vitit 2006<sup>70</sup> dhe se shpenzimet e kësaj natyre nuk mund të jenë kryer në një periudhë 10-vjeçare, bazuar në faktin e njohur se pjesa më e madhe e shpenzimeve të mobilimit (përfshirë pajisjet elektrike) janë shpenzime, që kryhen përpara fillimit të banimit, aq më tepër në kushtet e një familjeje me katër persona, ku fëmijët kanë qenë në moshën 3 dhe 6-vjeçare. Për sa i përket deklarimeve të subjektit, në lidhje me marrjen e dhuratave nga të afërmit dhe miqtë në vlerën mbi 10.000 lekë, konstatohet se këto dhurata nuk janë deklaruar në asnjërin prej deklaracioneve periodike vjetore në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”, sipas ligjit.

**11.3.** Për sa më lart dhe duke pasur parasysh sipërfaqen e apartamentit (sip. totale 106 m<sup>2</sup>), qytetin në të cilin ndodhet, çmimin e pajisjeve elektrike, si dhe faktin se subjekti nuk paraqiti asnjë provë shkresore për të provuar deklaracionet e tij, duket se shuma prej 500.000 lekësh, e deklaruar për mobilimin e këtij apartamenti, është jashtë logjikës së tregut. Lidhur me punimet

---

<sup>70</sup> Sipas deklaracionit në pyetësin nr. 1 dhe sipas adresës së deklaruar në DPV-në e vitit 2006, plotësuar në datën 16.11.2006.

e kryera, për efekt të analizës financiare, Komisioni e paraqiti shumën 1.480 euro si shpenzim, pasi subjekti nuk dorëzoi dokumentacion provues për kryerjen e punimeve dhe dhurimin e materialeve nga vëllai dhe shoku i tij.

**11.4.** Lidhur me mobilimin e apartamentit, me vendndodhje pranë Kopshtit Botanik, duke përfshirë edhe pajisjet elektrike, nuk ka kryer shpenzime pasi e ka marrë të mobiluar. Komisioni vlerëson se në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka dorëzuar një deklaratë (jototiale) nga shtetasit D.Xh. dhe S.Xh., ku deklarojnë se kanë banuar në apartamentin me sip. 131.71 m<sup>2</sup>, pranë digës së liqenit (apartamenti që i kanë shitur subjektit) gjatë periudhës shkurt 2008 – 15.6.2015 dhe se ky apartament ka qenë i kompletuar.

**11.5.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me faktin se vlera e deklaruar prej 500.000 lekësh, e shtrirë në kohë për një periudhë 10-vjeçare për shpenzimet e mobilimit në apartamentin ndodhur në Rr. “\*\*\*”, duket jo e arsyeshme, duke pasur parasysht sipërfaqen e tij, qytetin në të cilin ndodhet, çmimin e pajisjeve elektrike, si dhe faktin se subjekti nuk paraqiti asnjë provë shkresore për të provuar deklaratimet e tij.

**11.6.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se shuma prej 500.000 lekësh për mobilimin e këtij apartamenti nuk është jashtë logjikës së tregut, por është një shumë tepër e konsiderueshme, në kushtet kur orenditë për banim i ka sjellë nga apartamenti që ka pasur në Librazhd.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

**11.7.** Komisioni, duke pasur parasysht: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues në lidhje me shpenzimet për mobilim sipas deklaratimeve më lart, atëherë çmon se shuma prej 500.000 lekësh e deklaruar për arredimin e këtij apartamenti për një periudhë 10-vjeçare, është jashtë logjikës së tregut, duke pasur parasysht sipërfaqen e apartamentit, qytetin në të cilin ndodhet, si dhe çmimin e pajisjeve elektrike. Në vlerësimin e Komisionit, fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në pyetësorin standard se pajisjet kryesore i ka sjellë nga apartamenti i mëparshëm në Librazhd, e bën të pabesueshëm deklaratimin e tij, vetëm, pasi i është kaluar barra e provës.

**11.8.** Si konkluzion, subjekti rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës.

## **12. Analiza financiare**

**12.1.** Komisioni kreu analizën financiare duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, nga ku rezultoi se: për vitin 2005 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.741.523 lekë; për vitin 2006 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.275.685 lekë; për vitin 2007 ka mungesë

burimesh të ligjshme në shumën 1.126.324 lekë; për vitin 2008 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 145.948 lekë; për vitin 2014 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 178.819 lekë. Në total subjekti ndodhet me një balancë negative prej 5.468.298 lekësh për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e krijuara.

**12.2.** Pas kalimit të barrës së provës dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ripërllorarit të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit subjekti ndodhet me një balancë negative prej 5.068.298 lekësh për të justifikuar të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e krijuara, të detajuara në tabelën në vijim.

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
Përpara 2003	1,787,836	1,000,000	0	5,400,065	0	2,404,183	208,046	0
2004	0	-1,000,000	0	1,139,708	0	375,456	1,764,252	0
2005	6,378,800	0	103,917	1,891,392	3,443,440	513,637	-1,661,523	-1,661,523
2006	0	0	-55,117	1,360,075	-2,857,980	752,897	-2,195,685	-2,195,685
2007	0	0	-38,896	1,164,284	-1,088,190	1,161,314	-1,046,324	-1,046,324
2008	0	0	8,035	1,251,828	-739,095	570,646	-65,948	-65,948
2009	0	0	57,290	1,689,332	-685,850	652,299	293,893	0
2010	0	0	75,654	1,553,141	-694,050	583,900	199,537	0
2011	0	700,000	-131,134	1,662,310	0	649,767	443,676	0
2012	0	100,000	902,217	1,726,081	0	583,220	140,644	0
2013	501,050	-400,000	561,754	1,766,504	0	671,343	432,357	0
2014	0	400,000	668,028	1,988,090	0	1,018,880	-98,819	-98,819
2015	8,403,360	0	-1,910,641	1,942,843	5,903,360	1,051,249	302,235	0
2016	0	-100,000	-94,703	2,040,884	0	980,381	1,255,206	0
2017	-6,993,770	-500,000	5,280,444	5,134,365	-5,616,465	1,424,191	307,034	0
2018	1,975,251	-130,000	-1,926,306	2,153,456	0	976,682	1,257,829	0
<b>TOTAL</b>	<b>12,052,526</b>	<b>70,000</b>	<b>3,500,543</b>	<b>33,864,356</b>	<b>-2,334,830</b>	<b>14,370,044</b>	<b>1,536,413</b>	<b>-5,068,298</b>

**12.3.** Për sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### Vlerësimi tërësor i pasurisë

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, si dhe deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përmes postës elektronike; (v) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore; (vi) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis pasurive të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analiza ligjore e veçantë për çdo pasuri, konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij, sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- iv. Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 dhe ka dërguar një raport të arsyetuar nr. \*\*\*, datë 19.2.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2020 të KDZH-së, duke konkluduar mbi “papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Selim Kryeziu”.
2. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, është përcjellë raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Selim R. Kryeziu, me konstatimin për papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.
3. Konkretisht, nga informacioni i ardhur nga institucioni i verifikimit rezulton se: Për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari korruptive të një çështjeje penale në Gjykatën e Apelit, të cilat sinjalizojnë mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv në bashkëpunim.
4. Në përfundim, vlerësohet se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku z. Selim R. Kryeziu vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.
5. Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni mbi kontrollin e figurës**

6. Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në bashkëpunim me ONM-në, ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të zotëruar nga institucionet verifikuese, për t’i studiuar, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.

7. Komisioni, në sajë të informacioneve të marra nga raportet e DSIK-së, ka kërkuar informacion në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, ka informuar se nga verifikimet e kryera rezultoi se subjekti Selim Kryeziu është përmendur në referimin e fillimit të hetimit në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2019. Ky procedim është në fazën e seancës paraprake, pasi është dërguar për pushim hetimesh.
8. Gjithashtu, referuar në indiciet e DSIK-së, Komisioni ka thirrur në cilësinë e dëshmitares në datën 19.12.2019 shtetasen A. P., me detyrë prokurore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila u pyet lidhur me akuzat e ngritura nga ana e saj kundrejt subjektit Selim Kryeziu dhe shtetasit A. N., në cilësinë e anëtarëve të trupit gjykues në një prej çështjeve të hetuara prej saj. Sipas indicieve, prokurorja ka bërë disa komente në ambiente publike për shkelje serioze të bëra nga subjektet e mësipërme. Prokurorja A. P. deklaroi në Komision se nuk kujton të ketë pasur debate apo të ketë bërë komente lidhur me këto subjekte rivlerësimi në ambiente publike, pasi është shumë e kujdesshme në këtë pjesë, por nuk e përjashtoi mundësinë që edhe mund ta ketë harruar një fakt të tillë.
9. Për të verifikuar më tej figurën e subjektit, Komisioni kërkoj informacion në Ministrinë e Drejtësisë<sup>71</sup> dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor<sup>72</sup> në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot, si dhe administroi dosjet e përmendura<sup>73</sup> në indiciet e DSIK-së.
10. Komisioni, pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, vëren se ndaj subjektit Selim Kryeziu janë depozituar 3 ankesa<sup>74</sup>, si dhe referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor vëren se ndaj subjektit Selim Kryeziu janë depozituar 9 ankesa<sup>75</sup>.
11. Në analizim të dokumentacionit të administruar, raportit të dërguar nga DSIK-ja, si dhe verifikimit të të dhënave pranë organit shtetëror kompetent, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoj subjektit të paraqesë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me faktin se ka informacione për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, të cilat cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.
12. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës deklaroi se raporti i dytë i bërë në datën 19.2.2020 nuk është i mbështetur në prova dhe fakte të bazuara, por thjesht në dyshime aspak ligjore. DSIK-ja dhe institucionet e tjera që kanë përpiluar raportin kanë pasur detyrimin ligjor, bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale “Kallëzimi nga nëpunësit publikë” për të paraqitur kallëzim penal pranë organit të hetimit, nëse me këto akte është konstatuar se ka elementë të veprave të ndryshme penale, përndryshe mbajnë përgjegjësi ligjore për moskallëzim krimi. Subjekti kërkon t’i vihen në dispozicion të gjitha materialet dhe të dhënat e disponuara, që të ketë mundësi të paraqesë kallëzim penal në organet e hetimit. Lidhur me informacionet e marra nga Prokuroria e

<sup>71</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2020.

<sup>72</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2020.

<sup>73</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020, e Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>74</sup> Ankesë e shtetasit C. Sh., me nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2017; ankesë e shtetasit M. D., me nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2018; ankesë e shtetasit P. D., me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020.

<sup>75</sup> Ankesë e shtetasit M.V. e vitit 2007; ankesa e shtetasit M. I., e vitit 2013; ankesa e shtetasit S. J., e vitit 2013; ankesa e shtetasit Gj. P., e vitit 2014; ankesa e shtetasit P. P., e vitit 2014; ankesa e shtetasit Gj. P., e vitit 2015; ankesa e shtetasit Sh. D., e vitit 2007; ankesa e shtetasit M. V., e vitit 2016 (2 ankesa); ankesa e shtetasit Gj. D., e vitit 2017. Rezultoi se shtetasi Sh. D. ka paraqitur denoncime edhe në Komision.

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ku rezulton se është përmendur në referimin e fillimit të hetimit në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2019 (ky procedim është në fazën e seancës paraprake, pasi është dërguar për pushim hetimesh), subjekti deklaron se nuk ka dijeni për një procedimin penal ndaj tij, pasi nuk është thirrur ndonjëherë. Në kushtet kur ky procedim penal është pushuar ndaj personave që janë zhvilluar hetime, nuk duhet të përdoret tek vlerësimi i figurës.

13. Subjekti dorëzoi në seancën gjyqësore, në cilësinë e provës, vendimin nr. \*\*\*, datë 18.6.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku evidentohet kërkesa me objekt “Pushim i hetimeve për procedimin penal nr. \*\*\*, pasi nuk provohet se fakti ekziston”. Gjykata ka vendosur “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2019.”
14. Në lidhje me dëshminë e prokurores A. P., subjekti deklaroi se sulmet ndaj tij kanë filluar menjëherë pas gjykimit të masës së sigurimit të bashkëshortit të saj, shtetasit P. P., ish-prokuror i dënuar penalisht, si dhe gjykimeve të tjera civile me vëllain e saj G. Y., si paditës, ose si përfaqësues i palëve të ndryshme në cilësinë e avokatit.

#### **Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm**

15. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës; (ii) raportin e hollësishëm të DSIK-së; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se:
16. Konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësisht të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara, nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. 34.
17. Më tej, gjatë hetimit të Komisionit nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar në krimin e organizuar, si dhe nuk u arrit të vërtetohet përfshirja e tij në veprimtari korruptive në pozicionin e anëtarit apo kryesuesit të trupit gjyqësor në proceset gjyqësore.
18. Megjithatë, Komisioni arrin të shohë me rezervë faktin që subjekti nuk ka pasur dijeni për procedimin penal të nisur ndaj tij, si dhe dëshmitë kontradiktore të dhëna prej tij dhe prokurorja e thirrur në cilësinë e dëshmitares dhe megjithëse nuk arrin në një përfundim në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri, do të shprehet nëpërmjet ndikimit prej tij në vlerësimin tërësor që do të arrijë.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, është diplomuar dhe ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 25.3.1994. Pas studimeve, në datën 1.7.1994 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe në datë 24.1.1998 është emëruar kryetar i kësaj gjykate deri në datën 18.10.2006. Më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.10.2006, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka kaluar në detyrën e inspektorit të Inspektoratit të Këshillit të



Lartë të Drejtësisë. Në datën 17.5.2013 dekretohet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, detyrë që e ushtron edhe aktualisht.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

#### **a) Aftësitë profesionale**

***Njohuritë ligjore*** – subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, duke argumentuar lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë lidhur me kualifikimin ligjor të veprës, fajësinë dhe masën e dënimit. Gjithashtu, ka njohuri edhe lidhur me masat e sigurimit personal, vleftësimin, caktimin apo zëvendësimin e masës së dhënë me një masë më të butë.

***Arsyetimi ligjor*** – subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Struktura e vendimeve përfundimtare përgjithësisht është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural civil dhe penal. Subjekti është i qëndrueshëm dhe i mirëorganizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor, e cila ka ardhur në ngritje në këtë drejtim. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirës dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk është identifikuar asnjë rast nga pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Lartë për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Lidhur me tri dokumentet ligjore nuk evidentohet nëse ndaj tyre është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër, duhet evidentuar se në dispozitivin e vendimit, në pesë nga rastet e vëzhguara është konstatuar se nuk disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe nuk tregohet e drejta e rekursit për palët. Ndërsa në dy rastet e tjera është konstatuar se disponohet vetëm për shpenzimet procedurale, por nuk tregohet e drejta e rekursit dhe afati i paraqitjes së tij për palët në proces. Subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat ka arsyetim dhe përgjithësisht tregohet shkak ligjor.

#### **b) Aftësitë organizative**

***Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*** – subjekti, në periudhën e rivlerësimit, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke punuar në fushën e të drejtës penale dhe civile. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Selim Kryeziu rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 1 ditë, ndërsa kohëzgjatja më e gjatë ka qenë 1 vit, 5 muaj e 27 ditë. Në tri rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 4 muaj e 14 ditë, 6 muaj, 1 muaj e 5 ditë. Nga analiza e këtyre të dhënave në raport me standardet kohore të sistemit të vlerësimit, konstatohet se 4 çështje janë përfunduar brenda afateve standarde, ndërsa 1 çështje është përfunduar jashtë afateve standarde. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të gjatë të gjykimit, prej 1 viti, 5 muaj e 27 ditë ka qenë çështje civile themeli dhe në

përfundim është disponuar lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për këtë çështje duhet evidentuar se meqë seanca e parë caktohet nga kryetari, kohëzgjatja e çështjes nga kjo seancë deri në dhënien e vendimit përfundimtar për subjektin e rivlerësimit ka qenë vetëm 11 ditë. Për tri çështjet civile të vëzhguara që shqyrtohen në Gjykatën e Apelit, sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, seanca e parë gjyqësore caktohet nga kryetari i gjykatës, ndërsa gjykimet nga seanca e parë deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga subjekti i rivlerësimit janë gjykuar në afate shumë të shkurtra, pa pasur vonesa nga 11 ditë - 31 ditë. Ndërsa dy çështjet penale janë gjykuar brenda afatit standard të gjykimet.

Si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Evidentohet se pesë dosjet e vëzhguara janë arsyetuar brenda afateve ligjore, tri dosjet civile brenda afatit 10-ditor parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile dhe dy dosjet penale brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

***Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*** – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Subjekti është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve.

***Aftësia për të administruar dosjet*** – nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore përgjithësisht janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Aktet e njoftimit të palëve dhe aktet e tjera janë të përfshira dhe të renditura në dosjen gjyqësore. Në të gjitha dosjet vendimet e ndërmjetme fiksohen në seancë gjyqësore dhe përgjithësisht tregojnë shkakun ligjor.

### **c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

***Etika në punë, integriteti dhe paañësia*** – sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat e deklaruara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Po kështu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

### **d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

Është konstatuar se komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk janë konstatuar seanca gjyqësore të dështuara nga planifikimi për mospjesëmarrje nga vetë subjekti i rivlerësimit. Nuk ka pasur asnjë vonesë në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore në sekretarinë gjyqësore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë që kryen, ai i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit subjekti ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 13 trajnime. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vendin dhe kohën e aktiviteteve (jashtë vendit), pjesërisht shoqëruar me certifikata, të cilat janë jashtë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit.

### **Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale**

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë dhe konsiderohet “i aftë”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **DENONCIME**

1. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, janë administruar 18 denoncime nga publiku, si më poshtë vijon: (1) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2018, i paraqitur nga shtetasi M. D., i cili denoncon gjyqtarët A. N., dhe subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, për vendim të padrejtë; (2) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2018, i paraqitur nga shtetasja A. B., e cila denoncon trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Shkodër A. N., F. V., dhe subjektin Selim Kryeziu, për shkelje të etikës profesionale gjatë gjykimit, komunikim arrogant dhe njëanshmëri, si dhe zvarritje e procesit gjyqësor, si pasojë e riçeljes së hetimit; (3) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2018, i paraqitur nga shtetasi A. K., ngre ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me gjykimin e padrejtë. Sipas denoncuesit pretendimet e tij konfirmohen me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.3.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër (subjekti Selim Kryeziu është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues), e cila ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 11.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë gjykatës me një trup gjykues tjetër; (4) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2018, i paraqitur nga shtetasi D. P., i cili kërkon verifikimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 20.8.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, dhënë nga gjyqtarët Selim Kryeziu, A. N. dhe V. V.; (5) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2018, i paraqitur nga shtetasja M. N., e cila ankohet për 12 subjekte rivlerësi, ndër ta edhe z. Selim Kryeziu, duke pretenduar se i është mohuar e drejta nga veprimet, vendimet korruptive të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë. Shtëpia e saj është bërë e pabanueshme sepse në afërsi të saj jashtë çdo kriteri ligjor janë ndërtuar dy pallate 7 dhe 8-katëshe. Ajo ngre pretendime për dhënie vendimesh të padrejta (për 8 vendime) dhe kërkon të hetohet bazueshmëria e vendimeve gjyqësore; (6) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2018, i paraqitur nga shtetasi M. D., i cili ankohet për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër L. H., dhe A. N., pasi kanë marrë një vendim në mungesë të denoncuesit, si dhe ngre pretendime për korrupsion; (7) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2018, i paraqitur nga shtetasi Z. P., i cili ankohet për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, pasi si pjesë e trupit gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 13.2.2014, në shkelje të provave dhe ligjit; (8) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2019, i shtetasit N. K., i cili ankohet për subjektet Selim Kryeziu, V. O. dhe A. N., pasi ky trup gjykues nuk duhet të miratonte pushimin e çështjes, por të kthente aktet në prokurori dhe vazhdimin e hetimeve, pasi ato ishin të paplota dhe nuk duhet të linte në fuqi një vendim absurd të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas denoncuesit, në dispozitivin e vendimit Gjykata e Apelit Shkodër nuk është shprehur për kohën brenda së cilës lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, si dhe nuk është shprehur as për palët në mungesë kur i fillon afati i rekursit; (9) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018, i shtetasës R. Q., e cila ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti Selim Kryeziu, të cilin e etiketon si arrogant dhe në shkelje të etikës morale dhe profesionale. Denoncuesja pretendon se gjykimi është zhvilluar pa palën paditëse, duke u justifikuar me shpalljen dhe pa regjistrim audio në momentet e shkeljes së etikës ndaj palëve, shkelje të procedurës, mosshpallje të vendimit të arsyetuar dhe vendim i padrejtë; (10) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2018, i shtetasës M. N., e cila ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor; (11) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019, i shtetasës M. K., e cila ankohet për 11 subjekte rivlerësi lidhur me aftësitë profesionale të tyre dhe dhënien e vendimeve të padrejta; (12) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, i shtetasës A. N., e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë; (13) denoncimet anonime nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2019, të dërguar në rrugë elektronike në datat 3.3.2019, 4.3.2019 dhe 30.3.2019, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, është treguar i njëanshëm dhe ankohet për

vendim të padrejtë, si dhe akuzohet për korrupsion; (14) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2019, i shtetasit L. M., i cili ankohet për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër Selim Kryeziu, L. H., dhe A. K., lidhur me kallëzimin e depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Lezhë me objekt “Pushtim toke truall me sip. 495 m<sup>2</sup>”. Denoncuesi deklaroi se prokurori i çështjes nuk ka kërkuar të asgjësohen aktet e falsifikuara certifikatat e pronës, sipas nenit 391 të Kodit të Procedurës Penale dhe as Gjykata e Apelit nuk është shprehur lidhur me këtë pretendim të ngritur në ankimin e tij; (15) Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020, i shtetasit P. D., i cili ankohet për subjektet Selim kryeziu dhe A. N., të cilët duhej të kishin dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes civile, duke qenë se kanë shprehur mendim për veprimet e tij në një proces tjetër gjyqësor.

2. Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjithë aktet e tjera ligjore, Komisioni konstaton se nuk ka *indicie* dhe prova që të provohen faktet e pretenduara. Në denoncimet e paraqitura pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

3. Për sa më sipër, Komisioni, pasi kreu hetim të hollësishëm lidhur me denoncimet, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me to dhe pasi u shqyrtua në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

## **VLERËSIM TËRËSOR I TË TRI KRITEREVE**

1. **Në lidhje me rivlerësimin e pasurisë** – trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- iv. Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- v. Sikurse është arsyetuar më sipër, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia, pasi subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si kryetar gjykate dhe ka arritur të përfitojë strehim, rrethanë të cilën e ka shfrytëzuar menjëherë duke përfituar të ardhura monetare dhe jo për qëllimin për të cilin i ishte dhënë.

**2. Në lidhje me rivlerësimin e figurës** - trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore, pavarësisht nivelit të ulët të provueshmërisë gjatë hetimeve dhe megjithëse nuk arriti në një vlerësim negativ për këtë kriter, në vlerësimin tërësor gjen të zbatueshëm pika 5, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të të cilit kjo rrethanë mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

**3. Në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale** – Komisioni vlerëson se në bazë të të gjitha fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë dhe konsiderohet “i aftë”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**4.** Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.7.2020.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*